

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7716 E mërkurë 21 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës
Marrëveshja e arritur ditët e fundit ndërmjet Londrës dhe Komisionit Evropian mbi daljen e Britanisë së Madhe nga BE-ja është bërë molla ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE
Përse Brexit s'po gjen dot daljen?


Opinion **i** Ditës
Monika Kryemadhi ka lëshuar një apel në protestën e Unazës së Re, që kompania "Salillari" dhe Edi Rama të mos guxonin të prishnin shtëpitë e banorëve ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI
Salillari, Ramallari dhe ne të tjerët




Veliq: Të legalizuarit, dëmshpërblim 100%

Artistët tek Unaza e Re, i bashkohen protestës: Mos ju dorëzoni diktaturës

Reagon Rama: U deshën 15 vite që të protestonin.
Kryemadhi: Vidhen paratë e shqiptarëve

VALENTINA MADANI

Banorët e zonës së "Astirit" pavarësisht motit të keq, edhe dje protestuan duke bllokuar rrugën tek Unaza e Re shumë herë më të vendosur për të mos u tërhequr pa marrë garancinë për dëmshpërblimin ...
Në faqen 3

PERPLASJA/ DEKLARATA E AMBASADES, TAHIRI: PO FLISNI ME SHUME SE UNE VETE!

SHBA: HETIM SAIMIR TAHIRIT. ISH-MINISTRI: REAGIM ANORMAL

Ambasada amerikane: Të zbatohet ligji. Ish-ministri i Brendshëm: Nuk besoj kurrë se jeni kthyer në prokurori a gjykatë. Sulmon Andi Bushatin: Analist palaço



(Në foto) Ambasada amerikane në Tiranë. Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri



DEKRETI PER KREUN E KLSH
Manja paralajmëron rrëzimin e Tushës: Ka më shumë rëndësi reforma në drejtësi
Në faqen 4

EKONOMI
Apeli i FMN: Kujdes me koncesionet! Ahmetaj: Nuk kalon 5% të të ardhurave
Në faqen 5

TENSIONI NE GJYKATE
2 burgime përjetë për "Lazaratin", familjarët u kthehen gazetarëve
Në faqen 6

PASOJAT E DIALOGUT
INTERPOL-i refuzon kërkesën e Kosovës për anëtarësim, festë në Beograd
Në faqen 11

TREGU I PUNES
Lekcion me ekspertin e teknologjisë: "Luarasi" formon vetëm profesionistë
Në faqen 9

Ekskluzive/ Shkrimtari i njohur: Kur hyra në operacion, nuk kisha frikë

Sëmundja, beteja e fituar e Fatos Kongolit

"Rrëfimi im për Lilin, letërsinë, eutanazinë dhe ata që u detyroj jetën"

NGA FATMIRA NIKOLLI
Është mirë për ju të "Friend's Book House"? Të nesërmen, një burrë me xhakëtë kadife, me kapele beretë, shkelte gjethet e rëna, në rrugicën që ndahet prej "Myslym Shyrit" dhe e dëgjoja



të më rrëfente Shqipërinë e Kinën, duke u ndalur herë pas herë në disa ngjarje disi më gjatë. Ka kaluar pothuaj një dekadë prej herës së parë, kur kam takuar Fatos Kongolin. "Jetë në kuti shkrepësh" çmohej shumë nga lexuesit e megjithatë, shkrimtari ...
Në faqen 18-19

ZGJEDHJET OPOZITA

Zgjedhjet për krerët e PD mbyllen në 2 dhjetor, detyrat e grupit të punës

Valentina Madani

Zbardhet urdhri i Bashës: Siguroni barazi për kandidatët

Brenda dy javësh mbyllen zgjedhjet në degët e PD

Partia Demokratike mbledhi dje strukturat partiake e parlamentare për të diskutuar etapat e betejës opozitare, si dhe zgjedhjet e brendshme në parti. Të enjten e seancës plenare, kur në Kuvend do diskutohet projektbuxheti 2019-ës, kreu i PD-së në orën 10:00 ka thirrur një tryezë bashkëbisedimi me të njëjtin temë, me përfaqësues të biznesit, ekspertë, grupe interesi e gazetarë. Mësohet se: "Në vazhdim të shqetësimit mbi situatën ekonomike në vend dhe problemet shtesë që sjell projektbuxheti 2019 në ekonominë e vendit, PD nën kujdesin e kryetarit Basha organizon një bashkëbisedim me përfaqësues të biznesit, ekspertë, gazetarë e grupe interesi. Ditën e enjte, 22 nëntor, ora 10:00". Pjesë e diskutimit në mbledhjen e djeshme të grupit të deputetëve demokratë ishte edhe protesta e banorëve tek Unaza e Re, bashkë me vendimin që ajo të mbështetet në çdo kohë nga opozita. Mësohet se grupi i deputetëve demokratë diskutoi edhe për misionin e Komisionit të Venecias, që pas dy javësh të japë një qëndrim për vettingun në politikë. Në mbledhjen ku merrnin pjesë edhe aleatët e PD-së, kreu i grupit parlamentar, Edmond Spaho, informoi mbi takimin me delegacionin e Komisionit të Venecias për amendimin kushtetues të propozuar nga opozita, për vettingun në politikë. Zgjedhjet e brendshme në Partinë Demokratike ishin pika tjetër e diskutimit. Kryetari Basha kërkoi që procesi i zgjedhjes së kryetarëve të degëve të përfundojë brenda dy javëve. Ky proces i paraprin kuvendit kombëtar, që do mbahet në 15 dhjetor, e që do jetë zgjedhje për strukturat më të larta partiake. PD përgatitet që pas Kuvendit, të nisë punën për ngritjen e shtabeve elektorale për zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Me këtë strategji, opozita kombinon aksionin e vet politik me përgatitjet për vendoret e ardhshme. "Ne duhet të diktojmë axhendën e vendit, siç kemi bërë deri tani", mësohet të jetë shprehur z.Basha.

URDHRI
Partia Demokratike duke nisur që nga e enjta e ardhshme do të nisë procesin e zgjedhjeve të brendshme. Bëhet fjalë për procesin e zgjedhjeve për kryetarët e degëve. Kryetari i PD, Lulzim Basha ka firmosur ur-



AXHENDA
PD përgatitet që pas kuvendit, të nisë punën për ngritjen e shtabeve elektorale për zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Me këtë strategji, opozita kombinon aksionin e vet politik me përgatitjet për vendoret e ardhshme. "Ne duhet të diktojmë axhendën e vendit, siç kemi bërë deri tani", mësohet të jetë shprehur z.Basha.



Protesta e banorëve tek Unaza e Re

PD: DAKO I KA BËRË LLOGARITË GABIM
PD vijoi dje me akuzat në drejtim të Vangjush Dakos. Në një dalje për mediat, deputetja Valentina Duka tha se ai i fshihet opinionit publik, duke i kujtuar kryebashkiakut se llogaritë i ka bërë gabim. "Fshheja dhe heshtja për krimin elektorale në bashkëpunim me bandat, pazaret okulte që bën me Edi Ramën dhe prokurorinë, nuk prishin provat e dosjes voluminoze 339", tha zj.Duka.

"Plak autik", Hyseni ndryshon postimin pas kritikave


Berisha, akuza deputetit të PS: Supermafiozi u dha poste trafikantëve

Deputeti socialist, Alket Hyseni, përdori fjalë fyese ndaj ish-kryeministrit Sali Berisha, duke e quajtur "plak autik". Por, për përdorimin e këtij termi, reagon ashpër shumë deputetë të PD-së. Hyseni e ndryshoi statusin në të cilin i drejtohej me fjalën autik ish-kryeministrit Sali Berisha, por gjuha e përdorur shkaktoi reagime të forta. Fakti që përsëriti kaq shumë fjalën "autik" në formë fyese atij i është dashur të përballlet me një reagim masiv në rrjetet sociale, sipas të cilëve diskriminonte të sëmurët me autizëm. Por dje pas një lum akuzash ndaj tij në rrjetet sociale, përmes të cilave Hyseni i kërkohet të japë



dorëheqjen, deputeti ka reagu duke ndryshuar postimin. Në vend të fjalës, "autik", ai shkruan "i çartur". Por në reagimin e tij, ish-kryeministri Berisha shprehet se Alket Hyseni është "supermafioz dhe narkodeputet, që i ka kxhan trafikantët. Berisha zbardhi mesazhin e qytetarit dixhital. Mos rëstesisht Alket

Hyseni në Delvinë shoqërohej nga Agron Kohila. Djali Agronit, inspektor i Tati-meve në Tiranë, Ari Hohila. Nipi i Agronit inspektor në Tati-me, Fier, Niku Kohila. Nipi tjetër i Agron Kohilës, Gjergji Kohila ish-officer i policisë në qytetin e Vlorë dhe aktualisht është në kërkim nga policia dhe SHÇBA për trafikim narkotikësh. Emiliano Kohila, nip i Agronit bënte ligin në Portin e Sarandës punonte me makinë pa licencë taksit ishte dhe punonjës në port. E thërrisnin Emiliano Zapata. Këto janë postet që jep supermafioz Alketi për narkotrafikantët, Agroni ka qenë funksionar i lart i PS, Delvinë, kryetar dhe nënprefekt", thuhet në mesazhin dërguar z.Berisha.



Vokshi i përvishet Hysenit: Falja jote është e papranueshme

Deputetja e PD-së, Albana Vokshi reagoi ashpër ndaj deputetit socialist, Alket Hyseni, i cili e cilësoi ish-kryeministrit Sali Berisha si "autik" dhe "matuf". Vokshi tekta kritikon Hysenin, shkruan se ai ka përcmuar personat me aftësi ndryshe, me gjuhën e tij raciste dhe diskriminuese. Deputetja demokrate e cilëson të papranueshme ndjesën e Hysenit dhe teksta i drejtohet kryeministrit Edi Rama dhe grave të PS-së, shkruan se heshtja e tyre është e papranueshme. Vokshi i bën apel edhe kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi, të zbatojë nenin 6 të Kodit të Etikës, që ta ndalojë diskriminimin e mtejshëm të personave me aftësi ndryshe. Ndaj deputetit socialist, Alket Hyseni, reagoi edhe deputeti Bardh Spahia, Orjola Pampuri, tritan Shehu dhe Agron Shehaj. Shehaj e cilëson gjuhën e përdorur nga Hyseni fyese e denigruese. Shehaj thekson se çmimi më i mirë që ka marrë gjatë gjithë karrierës së tij është ai nga komuniteti i personave me sindromën Down. Ai kërkoi që deputeti socialist të kërkojë falje ose të japë urgjent dorëheqjen.

dhrin për zhvillimin e zgjedhjeve që do të mbahen nga data 23 nëntor deri në 2 dhjetor. "Në mbështetje të nenit 34 dhe 36 të Statutit të Partisë Demokratike, me

qëllim organizimin dhe mbajtjen e Kuvendeve të Degëve të Partisë Demokratike si dhe konstituimin e kryesive të degëve, urdhëroj: Organizimin dhe mbajtjen e

zgjedhjeve për kryetar të degëve të Partisë Demokratike, gjatë periudhës 23 nëntor deri në 2 dhjetor 2018", thuhet në shkresën e firmosur nga kreu i PD, Lulzim

Basha. Nëpërmjet këtij urdhri Basha i ka kërkuar grupit të punës që të organizojë zgjedhjet dhe t'i sigurojë kandidatëve akses të barabartë në listat e anëtarësishë,

prezencën e përfaqësuesve të tyre në komisionin e votimit dhe prezencën e përfaqësuesve të kandidatëve në procesin e numërimit të votave dhe shpalljen e rezultati.



Shpronësimet, Veliaj: Banorët janë regjistruar. Banori: ARRSH nxori emrin, s'jam paraqitur

Artistët solidarizohen me protestuesit: Edi Rama diktator, mos u dorëzoni

Kryeministri: U deshën 15 vjet që të protestonin

Valentina Madani

Banorët e zonës së Astirit pavarësisht motit të keq edhe dje protestuan duke bllokuar rrugën tek Unaza e Re shumë herë më të vendosur për të mos u tërhequr pa marrë garancinë për demshpërbllimin 100% të banesave të tyre që do t'u prishen për shkak të projektit të Unazës së Madhe. "Qeveri e korruptuar", "Nuk na ndalni dot", ishin disa nga thirrjet e vazhdueshme të protestuesve. Veç deputetëve të opozitës, në mbështetje të tyre ishin dhe aktivistët e mbrojtjes së Teatrit Kombëtar, aktori Neritan Liçaj, regjisori Robert Budina dhe pedagogu Ervin Goci, të cilët u solidarizuan me banorët. "Mos lëvizni nga vendi se kanë frikë ata. Të jeni të bindur se nga qytetari kanë frikë të gjithë diktatorët. Rama është një diktator në tentativë se nuk ka takat me qenë diktator. Por shumë shpejt do ta hajë kokën, siç po e ha. Të mos harrojmë pushteti se një ditë do t'i mblihdemi aty të gjithë shqiptarët se na ka ardhur në majë të hundës treçerekut të Shqipërisë. Qëndroni, qëndroni, asgjë nuk kanë çfarë t'u bëjnë", u shpreh z.Liçaj. Banorët paralajmëruan protesta pa afat. "Kërkojmë që këtyre që u kemi dhënë votën të vijmë të na takojnë. I bëj thirrje politikaneve dhe të vijmë të na takojnë se nuk u dhamë votën që të na bëjnë grupën. Presidenti Meta të mendojë për këtë popull. Qeveri hajdute, turp të kenë hajdutët. Ja ku jam, le të vijmë të ma arrestojnë", tha një nga banorët. Një tjetër banorë deklaroi se ARRSH e ka nxjerrë në listën e personave që janë paraqitur për konsultime, por kjo sipas tij nuk është e vërtetë. "Nxorën emrin e babait tim dhe timin në listën e ARRSH. Afrim Qendro tha se unë jam tërhequr. Janë mashtrime të Qendros dhe Veliajt. Nuk kemi takuar asnjë. Pse të shkojmë ne tek ARRSH, le të vijmë ata këtu. A i kanë vënë kryq shtëpisë këtu, le të vijmë të takohemi me kamera, s'kemi asgjë për të fshehur. Pse të venë banorët atje një nga një, le të vijmë ata këtu. Ne jemi të gjithë për një qëllim. Si mund të shkoj tek ARRSH. Pse ka frikë nga njerëzit. Pse duhet të shkojmë ne tek ARRSH. T'i bëjmë gjërat përballë kamerave dhe hapur", tha një tjetër banor.



Protesta e djeshme e banorëve tek Unaza e Re

politika dhe vlerësoi qytetarët të cilët i janë drejtuar institucioneve dhe kanë filluar procedurat e shpronësimit. "Jam shumë i lumtur që nga dje (nga e hëna) banorët e kanë kuptuar që ca politikanë po i përdorin dhe sot (dje) kanë shkuar të regjistrohen për t'u shpronësuar. Ky është një lajm shumë i mirë", deklaroi z.Veliaj. Kryebashkiaku siguroi se falë këtij projekti të qeverisë shqiptare, do të marrë zgjidhje edhe problemi i trafikut në një nga nyjet hyrëse në kryeqytet, ndërsa i cilësoi politikë të vjetër përpjekjet për të penguar projektet zhvilluese në qytet vetëm e vetëm për të përfutur vota. Veliaj deklaroi se Unaza e Madhe do të bëhet, ndërsa nënvizoi se askush nuk mund të bllokoi dot punët e qytetit. "Unaza do të bëhet, kompensimin do ta marrësh, por nuk e bllokoi dot qytetin. Një parti politike mund të ndihmojë, mund të të përdorë, mund të të manipulojë për sherr, për vota, të vish të dëmtosh bashkinë, por kjo bashki s'është e imja; do iki unë, nesër do jesh ti kryetarja e bashkisë, ndaj s'mund ta dëmtoj qytetin dhe as ta pengojmë progresin", u shpreh z.Erion Veliaj.

ERION VELIAJ

"Jam shumë i lumtur që nga dje (nga e hëna) banorët e kanë kuptuar që ca politikanë po i përdorin dhe sot (dje) kanë shkuar të regjistrohen për t'u shpronësuar. Ky është një lajm shumë i mirë. Unaza do të bëhet, kompensimin do ta marrësh, por nuk e bllokoi dot qytetin", deklaroi z.Veliaj.



"Unaza e Re", LSI: Qytetarët të nxjerrin deputetët jashtë Kuvendit

Zëvendëskryetari i LSI-së Luan Rama i ftuar në rubrikën "Opinion" në News 24 komentoi dje protestën e banorëve të zonës së Astirit, të cilët kundërshtojnë vendimin për të prishur ndërtesat pa marrë më parë demshpërbllimet. Sipas tij, LSI-ja mbështet në shenjë solidariteti qytetarët në kauzën e tyre, sepse ata janë në të drejtën legjitime të tyre, pasi në atë zonë nuk ka një leje për të ndërtuar. Ai foli edhe për mungesën e dialogut politik, reformën në drejtësi, por pa harruar edhe qëndrimet e maxhorancës, e cila sipas tij po krijon kosto të madhe për rrugën europiane të vendit. Gjithashtu, Rama u bëri thirrje qytetarëve të vijmë dhe të nxjerrin deputetët nga Kuvendi, pa dallim nga ngjyrat partiake me qëllim zgjedhjen e qeveritarëve të duhur. "Në protestë tek Unaza e Re në formë solidariteti me qytetarët. Mirë do ishte të ishin tek ata edhe deputetët e mazhorancës. Unë jam pro përmirësimit, zhvillimeve infrastrukturorë. Në rastin konkret jemi përballë një arbitrariteti. Shteti nuk po ndjek standardet ligjore, pse iu kërkon qytetarëve të respektojnë këto standarde ku qeveria nuk i zbaton. Kemi në prapavijë interesa korruptive në këtë zonë. Nëse jemi në një fazë, e cila nuk ka një leje ndërtimi. Duhet të demshpërblehen paraprakisht, ky është një detyrim ligjor. Të demshpërblehen për dëmin që u shkaktohet. T'u jepet shuma që mund të marrin më pas një shtëpi tjetër", - tha Rama.

REAGIMI

Kryeministri Edi Rama reagoi mbrëmë përmes një postimi në Twitter për protestën e banorëve në zonën e Astirit teksa paralajmëroi se për këtë çështje do të flasë ditën e enjte në seancën parlamentare. "Qysh nga prishja e parë masive në Parkun Rinia, u desh të kalonin mbi 15 vjet prishje për interes publik, që të protestohet me kërkesën për demshpërbllim për ndërtimet pa leje në shtratit e rrugës! E dini pse? Kjo s'thuhet me një tweet, meriton një shtjellim të plotë para Kuvendit!", - shprehet z.Rama.

GARANCIA

Kreu i Bashkisë Erion Veliaj garantoi dje se pronarët që preken nga projekti i ndërtimit të Unazës së Madhe do të shpronësohen 100%, ndërsa për ndërtimet pa leje Bashkia e Tiranës ofron tre vite bonus qiraje dhe mundësi për banesa sociale. Veliaj shfrytëzoi dje Këshillin e Fëmijëve, me nxënësit e të gjithë shkollave të kryeqytetit dhe përfaqësues të UNICEF-it në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, për të sqaruar se banorët që preken nga projekti janë përfutur të paketave sociale. Ai kërkoi nga banorët që të mos përdoren nga

Kryetarja e LSI: Rama të mos u afrohet banesave

Unaza e Re, Kryemadhi: Projekti vjedh paratë e shqiptarëve, s'do ta tolerojmë

Kryetarja e LSI, Moni Kka Kryemadhi iu bashkua dje protestës së banorëve të Astirit, shtëpitë e bizneset e të cilëve preken nga ndërtimi i Unazës së Re. Me projektin në dorë Kryemadhi shpjegoi arsyet se përse ky investim është abuziv. "Kjo është vija e kuqe që s'pothet për të zgjeruar rrugën. Këtu shkon me ishull gjelbërimi dhe rrugë ku kalonin makinat sot edhe është postuar 20 e ca metra në pronat e qytetarëve. Ndërkohë po të shikoni këtu, këtu nuk ka as ishull dhe as rrugë, por ka një pronë, pronari i të cilës është Damian Gjinkuri", deklaroi znj.Kryemadhi. Ajo garantoi banorët se LSI do të jetë në mbështetje të tyre në këtë proces, ndërsa i kërkoi kryeministrit t'i demshpërblejë 100%. "Duhet t'i demshpërblejë se këta njerëz kanë 22 vjet që paguajnë. Kjo është shumë e turpshme dhe ky është mallkimi dhe mallkimi i fukarait të zë 7 breza. Kryemadhi i bëri thirrje Ramës që të mos afrohej dhe të prish



tetjetë të tyre në këtë proces, ndërsa i kërkoi kryeministrit t'i demshpërblejë 100%. "Duhet t'i demshpërblejë se këta njerëz kanë 22 vjet që paguajnë. Kjo është shumë e turpshme dhe ky është mallkimi dhe mallkimi i fukarait të zë 7 breza. Kryemadhi i bëri thirrje Ramës që të mos afrohej dhe të prish

banesat pa demshpërbllim. "Projekti në të cilën Edi Rama në unazën e re, do të vjedh paratë e shqiptarëve. Pronat e shqiptarëve, nuk i konsiderojnë. Ja ku është një pallat që i shikoni, nuk s'pothet rruga 10 metra, por zgjerohet këtë nga fukarenjtë dhe hallexhinjtë. Edi Rama duket ta kuptojë shumë, se shqiptarët e toleruan me votën. Po i bëj thirrje, atij një, Afrim Qendros 2 dhe kompanive që duan të ndërtojnë rrugë, të mos afrohen këtu. Këta qytetarë nuk kanë për të toleruar. Këta që po shkatërrojnë banesat, për të fituar lekë. Ky njeri duhet t'i demshpërblejë se kanë 27 vjet që paguajnë taksat", theksoi Monika Kryemadhi.

DEKRETI VOTIMI

Shumica qeverisëse ka paralajmëruar votën kundër zgjedhjes së Vitore Tushës

PS drejt rrëzimit të dekretit të Metës për kreun e KLSH-së

"Primare për ne mbetet jetësimi i reformës në drejtësi"

Mazhoranca duket se është e gatshme që të hapë një tjetër konflikt me Presidentin e Republikës, Ilir Meta. Kjo pasi shumica qeverisëse është e gatshme të rrëzojë propozimin e kreu të shtetit për të zgjedhur Vitore Tushën në krye të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Këtë ka lënë të kuptohet kryetari i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja, i cili gjatë një interviste për emision "45 minuta" ka deklaruar se Vitore Tusha është anëtare e Gjykatës Kushtetuese dhe si anëtarja me më shumë përvojë në këtë institucion është edhe automatikisht nënkryetare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Sipas tij zgjedhja e saj në KLSH do të krijonte një boshllëk në një nga institucionet kyçe për vijimin e ngritjes së disa institucioneve të reja që janë parashikuar nga reforma në drejtësi. Dhe sipas socialistëve reforma në drejtësi ka më shumë rëndësi se sa KLSH. "Ne e kemi bërë të qartë qëndrimin tonë që ndërmjet KED i hap rrugë krijimit të Gjykatës Kushtetuese dhe shpalljes së garës për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, dy organe të rëndësishme, jetike për vendin. Ne kemi thënë që primare për ne si mazhorancë, mbetet jetësimi dhe zbatimi me sukses i reformës në drejtësi. Ky është qëndrimi i qartë politik i joni"

dhe nga ky short del përbërja e KED që janë një anëtar i Gjykatës së Lartë, dy anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme,

dy nga prokuroritë e Apelit, dy gjyqtarë nga gjykatat e apelit, dhe një gjyqtar i Administrativës. Kjo është përbërja me 9 anëtarë e KED. Nga praktikatat e dy viteve të

mëparshme, ne presim një vendimmarrje nga Presidenti. Nëse nuk e ushtron të drejtën e shortit, kushtetuta ia kalon Kuvendit, i cili ndërmjet 5-10 dhjetor është i detyruar të hedhë shortin", tha Manja. Në fakt këtë vendimmarrje për rrëzimin e Vitore Tushës e paralajmëroi pak ditë më parë edhe kryetari i grupit socialistë, Taulant Balla, i cili teksa vlerësoi pozitivisht kandidaturën e saj, tha se gjithësi për mazhorancën më e rëndësishme ishte reforma në drejtësi. Natyrisht që në rast se mazhoranca do të votonte kundër kandidaturës së saj, atëherë ky do të ishte një shkak tjetër që përplasia mes shumicës dhe presidentit të vazhonte edhe më tej.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko dhe shefi i misionit, Jan Kees Martijn



Vitore Tusha, anëtare e Gjykatës Kushtetuese

Ministria e Drejtësisë priti ekspertët e "Venecias"

PS: Vetingun në politikë do e bëjmë përmes reformës në drejtësi

Në vijim të takimeve me përfaqësuesit e partive dhe institucioneve shqiptare, delegacioni i Komisionit të Venecias është takuar dje edhe me ministrin e Drejtësisë, Etilda Gjonaj. Ministria vlerësoi rolin e Komisionit të Venecias si një partner shumë i rëndësishëm që ka kontribuar dhe bashkëpunuar efektivisht në shumë procese të rëndësishme për Shqipërinë dhe sidomos për reformën në drejtësi. Gjatë takimit ministria Gjonaj iu përgjigj interesimit të tyre lidhur me projektin propozim të Partisë Demokratike për vetingun e politikaneve, duke vënë theksin tek ngritja e institucioneve



të reja të drejtësisë, të cilat do të bëjnë pastrimin e politikës nga zyrta të inkriminuar apo të korruptuar. Ajo u shpreh se tashmë është vendosur një standard i ri me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 për reformën në drejtësi, duke lu nënshtruar më parë një procesi konsultimi me konstitucionalistët, ekspertët dhe shoqërimin civil, standard i cili duhet të ruhet

në çdo rast të ndryshimeve kushtetuese. Sistemi i ri i drejtësisë, ngritja e institucioneve të SPAK garantojnë ndëshkueshmërinë e zyrtarëve të lartë pasi është një sistem i depolitizuar dhe i pavarur. Ndërkohë që nga ana tjetër përfaqësuesit e opozitës këmbëngulin që edhe për politikanët të ushrohet i njëjti standard si edhe me gjyqtarët dhe prokurorët. Ministria i informoi anëtarët e Venecias lidhur me ndryshimet e kuadrin ligor për përjashtimin e të gjithë kompanive duke përfshirë dhe administratorët dhe ortakët, të cilët kanë precedentet penale, për të përfituar nga fondet publike.

MANJA

"Ne e kemi bërë të qartë qëndrimin tonë që ndërmjet KED i hap rrugë krijimit të Gjykatës Kushtetuese dhe shpalljes së garës për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, dy organe të rëndësishme, jetike për vendin. Ne kemi thënë që primare për ne si mazhorancë, mbetet jetësimi dhe zbatimi me sukses i reformës në drejtësi. Ky është qëndrimi i qartë politik i joni"

SHKURTE

Paketa Antishpifje, në Kuvend për votim pas janarit

Kryeministri Edi Rama në kuadër të vizitës së tij në Austri ka morri pjesë në Forumin "Ekonomia takohet me politikën", zhvilloi një takim edhe me përfaqësuesin e Lirisë së Medias në selinë e OSBE, Harlem Desir. Lajmin e ka bërë të ditur vet kryeministri Rama nëpërmjet foto komentit në rrjetet sociale, ku dhe ka publikuar foto nga takimi, ndërsa thekson se temë e diskutimeve ishte dhe kuadri i ri ligor për disiplinimin e portaleve dhe shpifjes në përgjithësi. "Në selinë e OSBE në Vjenë me Harlem Desir, përfaqësuesi për Lirinë e Medias, pas një diskutimi të dobishëm mbi Paketën Antishpifje dhe kuadrin e ri rregullator të portaleve - së shpejti çelim konsultim publik dhe pastaj në Kuvend pas Vitit të Ri", shkroi Rama.

Ambasadori i BE: Miratoni reformën zgjedhore 6 muaj para zgjedhjeve

Bashkimi Europian kërkon miratimin sa më parë të Reformës zgjedhore, si një hap i rëndësishëm për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve të ardhshme vendore. Nga Tani ambasadori i Bashkimit Europian në Tiranë Luigi Soreca deklaroi se kjo reformë duhet të miratohet sa më parë, duke nënvizuar faktin se ajo duhet të rregullohet 6 muaj para zgjedhjeve vendore të 30 qershorit 2019. "Zgjedhjet vendore janë shumë të rëndësishme, sepse në këto zgjedhje qytetarët zgjedhin ata që do merrin me problemet e tyre. BE pret që të ketë një reformë zgjedhore ashtu si është rekomanduar nga OSBE/ODIHR. Reforma është me rëndësi që të kryhet 6 muaj para datës së zgjedhjeve. Puna që është bërë deri më tani për reformën zgjedhore është e mirë, por duhet të përfundojë. Kjo është një pikë shumë e rëndësishme dhe BE e konsideron prioritet", tha ambasadori.

Njoftim shtjete me ankand

Shoqëria përbarimorë "AA Bailiff" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Tuaril 128 m2 dhe ndërtesë 81 m2, me Nr. pasurie 2/339, ZK 8511, vol. 15, fq. 127, në pronësi të Qemal Murrut Skora e regjistruar në ZVRPP Durrës.

Cmimi i ankandit të trete është EUR 40,118 (dyzetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë euro).

Ankandi zhvillohet dt. 03.12.2018, ora 16:00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati III-të, Tiranë.

Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabailiff@gmail.com.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton: Shpalljen e Ankandit të I-të, për shitjen e pasurisë ULLISHTE, me sip.3.400 m², Zona Kadastrale: 1615

Numri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Sefer Skraqi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me ciminin fillestar në vlerën 2.720.000 (dy milion e shtatëqind e njëzet mijë) LEKE.

Ankandi do të zhvillohet më datë 21.11.2018, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042322227, email: givinth@hotmail.com.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 23.11.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/068 904 9202, e.mail besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të dorëzuaritë Baftjar Alush Murto.

"Trulli + Ndërtesë" me sipërfaqe tuaril 300 m² dhe ndërtesë 81 m², regjistruar në regjistrin hipotekor me volum nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. pasurisë 987, adresa: Shalës, Sarandë.

Cmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 907 200 (nëntëqind e shtatë mijë e dyqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientin e Shoqërisë Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.



Tri institucionet financiare vlerësojnë ecurinë e ekonomisë shqiptare

Mbyllet misioni, FMN: Kujdes me koncensionet!

Sejko: Deficiti dhe borxhi, në rënie

Me rastin e largimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Shqipëri, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj; guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko dhe shefi i misionit Jan Kees Martijn kanë dalë mbrëmë në një konferencë të përbashkët për mediat, ku kanë vlerësuar ecurinë e ekonomisë së Shqipërisë dhe prishmëritë e buxhetit të ri. Gjatë fjalës së tij, guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko deklaroi se deficiti buxhetor është ulët dhe borxhi publik është në rënie të vazhdueshme. "Duhet të vijojnë reformat strukturore në Shqipëri. Deficiti buxhetor i ulët dhe borxhi është në rënie. Bazat e zhvillimit të vendit mbeten solide, ndërsa duhet përmirësim i zhvillimit të sistemit financiar", tha Gent Sejko. Ai gjithashtu theksoi se çelja e negociatave duhet parë si një instrument parësor i zhvillimit të vendit. Sipas tij, Banka e Shqipërisë, vlerëson se përbushja e kritereve për çeljen e negociatave është me rëndësi të madhe për ecurinë ekonomike të vendit. Po ashtu, një tjetër faktor ndikues në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm sipas Sejkos është edhe zhvillimi i sistemit financiar. Ndërsa është ndalur më tej tek sektori bankar, ai ka deklaruar se ky i fundit paraqitet i qëndrueshëm dhe shfaqet rezistent ndaj situatave të mundshme të stresit. "Sektori bankar është i qëndrueshëm, me përmirësim të kapitalit dhe likuiditetit. Ky sektor shfaqet rezistent, ndaj situatave të mundshme të stresit. Kjo analizë pasqyrohet edhe në projeksionet tona, që parashikojnë vazhdimin e rritjes ekonomike në planin afatmesëm", u shpreh Sejko.



DEFICITI

"Duhet të vijojnë reformat strukturore në Shqipëri. Deficiti buxhetor i ulët dhe borxhi është në rënie. Bazat e zhvillimit të vendit mbeten solide, ndërsa duhet përmirësim i zhvillimit të sistemit financiar", - tha Gent Sejko.

Ministri i Financave: Papunësia ka nisur të bjerë

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, në kuadër të mbyljes së misionit të radhës së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Tiranë, ka dalë në një konferencë për mediat, ku tha se falë partneritetit me FMN-në, Shqipëria ka një situatë makroekonomike dhe fiskale të konsoliduar. "Përtej sfi-dave të reformave, doja të fokusohesha në disa nga zhvillimet ekonomike dhe parashikimet. Rritja ekonomike ka vijuar të përshpejtohet. Për 6 muajt e parë, rritja është në nivelin 4.4% nga 3.8 që ishte në 2017, e pritet të jetë mbi 4% gjatë gjithë vitit", deklaroi Ahmetaj. "Zgjerimi i aktivitetit ekonomik është reflektuar dhe në tregun e punës. Papunësia ka nisur të bjerë dhe punësimi është rritur", shtoi ministri. Ai tha se Investimet e huaja direkte do të jenë më shumë se 1 miliard euro këtë vit, duke kaluar edhe pritjet fillestare.



Ministri i Financave ka debatuar me kryetarin e komisionit

Ahmetaj: PPP, brenda nivelit prej 5%. Nuk do ketë më oferta të pakërkjuara

Komisioni i Ekonomisë Kmiratoi dje në parim projektbuxhetin e vitit 2019. Ndërkohë që para se të kalonte në votim, deputetët e këtij komisioni kanë zhvilluar një debat të gjatë teknik mbi disa prej risive që sjell ky buxhet dhe në mënyrë të veçantë të marrëveshjet sipas formulës Partneritet Publik-Privat dhe kostot e rritura të kontratave koncensionare. Ministri i Financave tregoi se bëhet fjalë për 1.2 miliardë euro investime, që nuk mund të bëheshin me paratë e buxhetit të shtetit. Sipas ministrit të Financave, nëse nuk do të ishte zgjedhur kjo mënyrë ndërtimi i Rrugës së Arbrit apo mirëmbajtja e Durrësit dhe për financat e shtetit edhe për një dekadë në vijim. Ndërsa deputeti so-



cialist Erjon Braçe kërkoi të dijë se përse rrugët me koncension kanë vlerë më të madhe se sa ato të parashikuara në buxhetin e 2018. Sipas ministrit të Financave, ky ndryshim vjen për shkak se oferta në fillim ka qenë bazuar mbi një studim të përgjithshëm, ndërsa më pas është bërë detajimi i projekteve, çka ka sjellë dhe kostot reale. "Në fillim ishte ide, kurse tani është projekt i detajuar dhe

është kostuar sipas manualit të çmimeve të AKBN", tha Ahmetaj. Kreu i Financave tha se kostot janë rritur edhe për rrugët e ndërtaura nga buxheti i shtetit duke marrë shembull autostradën Tiranë-Elbasan. Referuar koncesioneve për vitin 2019, ministri informoi se janë përbushur detyrimet e neneve të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ku kufiri i totalit të vlerës vjetore të kontratave koncensionare nuk duhet të kalojë nivelin 5% të ardhurave të parashikuara në vitin paraardhës. Ahmetaj informoi se nga 1 Korriku 2019, do të hiqet mundësia për oferta të pakërkjuara në disa sektorë, ndërsa është shprehur i sigurt për mosprekjen e tavanit të koncesioneve prej 5 për qind të të ardhurave tati-more të vitit paraardhës.

Buxheti i Shëndetësisë, Rama: Rritje pagash dhe investime në spitale

Dje ishte radha e buxhetit të Shëndetësisë për t'u pre-zantuar nga kryeministri, Edi Rama, si një nga sektorët e tjerë që do të përfitojë vitin e ardhshëm nga rritja e pagave. Vetë Rama ka deklaruar se, 17.864 mjekë e infermierë do kenë sërish rritje page nga tre mujori i dytë i vitit të ardhshëm. "Përsëri ne do rrisim pagën për infermierët e mjekët. Janë 17.864 punonjës që do kenë një rritje page prej 7 për qind nga tremujori i dytë i vitit të ardhshëm. Një rritje e konsiderueshme besoj që përbush objektivin tonë për pagën e infermierëve dhe që rrit edhe shpërblimin e mjekëve", tha Rama në fjalën e tij. Ai premtoi më tej se do të ketë edhe rritje të buxhetit për rimbursimin e barnave dhe investimet nëpër spitale të vendit.

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shijën e pasurisë së paluajshme për të cilën ka vene hipoteke NBG BANK, me kelo të dhëna:

Truall Zk. 3064 nr. pasurisë 90/21, vol. 2 fq. 240 94 m2 ndertesa 250 m2. në pronësi të Ali Ibrahim Alushi ndodhur në adresën Prush, Tiranë.
Cmimi me të cilin fillon ankandin është në vlerën 12.000 (dymbëdhjetë mijë) EUR.
Ankandit zhvillohet në datën 05.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890 CEL. 069317499.

FMN Ndërkohë që përfaqësuesit e FMN-së janë shprehur se formula e Partneritetit Publik-Privat është një mundësi për përmirësim të menaxhimit të projekteve, por duke vënë theksin se ka disa vende ku PPP kanë shkuar në probleme financiare dhe përdorimi i tyre duhet të jetë shumë i kujdesshëm. Gjithashtu, kreu i misionit të FMN-së, Jan Kees Martijn u shpreh se ekonomia e Shqipërisë ka prirje rritëse, por në të njëjtën kohë mbetet ende shumë për të bërë që ajo të jetë më e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe sidomos amortizuese për emigracionin. Ai tha se qeveria shqiptare duhet të zbatojë reformat strukturore, në mënyrë që të dekurajojë emigracionin e lartë. "Parashikojmë rritje ekonomike 4% këtë vit dhe 3.7% vitin e ardhshëm. Ndërsa në periudhë afatmesme shkalla e rritjes do të jetë 4% e mbështetur nga rritja e eksporteve

dhe investimeve në infrastrukturë dhe turizmit", tha përfaqësuesi i Misionit të FMN-së, Jan Kees Martijn. Gjithashtu, ai shtoi se rreziqet ndaj ekonomisë shqiptare vlerësohen në rënie. Shqipëria është ekspozuar nga rreziqet me vendet partnere në Europë, dobësitë e të cilave do të ndikojnë negativisht në investimet e huaja, të ardhurat nga emigrantet dhe eksportet. Ndërsa në rrafshin fiskal, FMN-ja sugjeroi se konsolidimi fiskal

duhet përshpejtuar. "Nevojitet ulja e deficitit fiskal. Ne projektojmë se në mungesë të masave fiskale shtesë deficitit fiskal do të jetë jo më pak se 2% e PBB-së. Reduktimi i borxhit publik do të jetë më i ngadaltë se pritjet tona", tha eksperti i Fondit. Eksperti FMN tha se rritja e shpejtë e PPP-ve kërkon përmirësimet shtesë në të gjitha nivelet e qeverisjes, ndërsa kërkoi që rritja e detyrimeve të prapambetura duhet të trajtohet pa vonesë.

“Lazarati 2”, avokati: 11 koka turku, vrasësi i efektivit Basha është i lirë

TIRANË

Tension, dhunë verbale e fizike, ndaj gjykatësve, prokurorit e gazetarëve. Ishte gjithçka ndodhi pasditen e djeshme në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, kur u shpall vendimi për 11 të pandehurit e dosjes “Lazarati 2”, të cilët u cilësuan fajtorë lidhur me ngjarjen e tri viteve më parë, ku u vra efektiv i RENEA-s, Ibrahim Basha dhe u plagosën disa kolegë të tij. Përplasja nisi që në momentin kur gazetarët hynë në sallën e gjyqit për të përcjellë procesin dhe po qëndronin në pritje që treshja gjyqësive të shpallte vendimin përfundimtar. Familjarët sulmuan verbalisht përfaqësuesit e medias, por me ndërhyrjen e njërit prej avokatëve, situata u qetësua. Situata u agravua më shumë në momentin kur treshja gjyqësive e kryesuar nga Idriz Mulkurti shpalli verdiktin e saj. Konkretisht, Arbjon Aliko dhe Bajram Boci u dënuan me burgim të përjetshëm, Elvis Boci me 35 vite burgim, ndërsa të tjerët me masa dënimi, që variojnë nga 9 deri në 18 vite burg. Ata u cilësuan fajtorë për vrasjen e specialit Ibrahim Basha dhe plagosjen e 5 të tjerëve, kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Ende pa mbaruar fjalën kryesuesi i seancës, të afërmit e të pandehurve rrëmbyen karriget dhe tentuan të godisnin gjykatësit prokurorët dhe gazetarët e pranishëm, ndërsa mallkonin me shprehjet ju vdekshin fëmijët tuaj si dhe hidhnin kërcënime në drejtim të të gjithëve, se “do të merrnin hak”. Të pandehurit nga ana tjetër tentuan të shkatëronin mikrofonat në kafazin e xhamtë. Sulmi i paprecedentë ndaj medias vijoi dhe në ambientet e jashtme të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Pavarësisht ndërhyrjes së forcave të policisë së burgjeve, ishte e pamundur mbajtja nën kontroll të të gjithë personave të pranishëm, pasi ishin mbi 30 të tillë. Situata e krijuar vuri në lëvizje Policinë e Shtetit, forcat e të cilës mbërritën afro 15 minuta më vonë, për të marrë situatën nën kontroll dhe nisën hetimet për ngjarjen, e cila nuk do të kishte agravuar, nëse do të ishin marrë masa më të rrepta sigurie. Kjo për faktin se edhe në shkallë të parë, familjarët e këtyre të pandehurve, kanë krijuar incidente. Në fund të procesit, avokati Bashkim Nikolla kërkoi falje mediave, ndërsa kundërshtoi ashpër vendimin që drejtësia firmosi për të pandehurit.

REAGIMI I AVOKLATIT

Pas vendimit të dhënë nga Apeli i Krimeve të Rënda për dosjen “Lazarati 2”, që u shoqërua me tensione të mëdha në sallën e gjyqit, verdhë reagimi nga avokati mbrojtës. Teksa është distancuar nga dhuna e familjarëve në sallën e gjyqit, avokati Bashkim Ni-

“Luftë” te Krimet e Rënda, lazaratasit godasin me karrige gjyqtarët e gazetarët

Sulmi, pas vendimit të Apelit për të pandehurit



Gjykata e Krimeve të Rënda

VENDIMI PËR ANËTARËT E GRUPIT TË LAZARATIT

1. Arbjan Aliko	burg përjetë
2. Borjan Boçia	burg përjetë
3. Elvis Boçia	35 vite burg
4. Xhulio Malo	10 vite burg
5. Albion Aliko	17.6 vite burg
6. Elson Kazma	17.6 vite burg
7. Klodian Selimi	13 vite burg
8. Oltion Proko	9 vite burg
9. Dervish Çoko	18 vite burg
10. Rohan Hirja	18 vite burg
11. Iliaz Xhaferaj	15 vite burg

Operacioni në Lazarat, ja si u ekzekutua efektiv i RENEA-s, Ibrahim Basha

Në orët e para të mëngjesit të 24 qershorit të vitit 2015, forcat e policisë kanë nisur operacion në zonën e Lazaratit, pasi kishin informacione se disa të rinj po përparitshin për veprime kriminale. Gjatë kontrolleve të ushtruara pranë qendrës së fshatit, forcat speciale kanë arrestuar në flagrancë shtetasin Xhulio Malo, i cili po drejtonte një mjet, ku gjendeshin armë të ndryshme dhe lëndë narkotike kokainë. Pas arrestimit, forcat speciale kanë njoftuar kolegët e tyre, të cilët gjendeshin në një furgon, për të realizuar shoqërimin e Malos. Në



Viktima Ibrahim Basha

momentin që furgoni po afrohej, ndaj tij është qëlluar me armë zjarri nga një largësi rreth 200 metra. Nga goditjet me armë ka mbetur i vdekur efektiv i policisë, Ibrahim Basha, si edhe janë plagosur efektivët Jetmir Isai dhe Perlat Hamitaj. Në vijim të operacionit policor dhe më tej, nga hetimet e drejtuara nga Prokuroria për Krime të Rënda, u arrit të identifikoheshin dhe të arrestoheshin 11 pjesëtarë të grupit të strukturuar kriminal.

kolla tha se të pandehurit janë bërë koka turku, pasi sipas tij, vrasësi i efektivit të RENEA-s Ibrahim Basha, është i lirë. Po ashtu, ai tha se familjarët do t'i drejtohen Gjykatës së Lartë. “Do i drejtohem Gjykatës së Lartë. Apeli s’na dha as gjykimin e shkurtuar. Një e drejtë e fituar nuk është e drejtë e mohuar, humbëm të drejtën e gjykimin të shkurtuar. Ngjarja nuk është hetuar dhe s’është marrë vendimi të hetohet për vrasjen e Bashës. Asnjë hetim, asnjë pyetje, asgjë. Ai është vrarë me një plumb tjetër, në mënyrë të tillë që godasin vetëm snajpera. Nuk është vonë që çështja të kthehet. Dhuna nuk duhet të ndodhte, por psikologjikisht kanë qenë shumë rënde. 11 koka turku, vrasësi i Ibrahim Bashës është ende i lirë”, u shpreh avokati.

Sekuestrohen 360 mijë euro pasuri në Vlorë, dyshohen të jenë siguruar nga trafiku i drogës

VLORË - Me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë, në Vlorë janë sekuestruar 360 mijë euro pasuri, që rridhin nga burime jo të ligjshme. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se bëhet fjalë për pasurinë e shtetasit me inicialet J.J., pasi ai akuzohet si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale: “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë penale”. Konkretisht, këtij shtetasi i janë vënë nën sekues-



tro preventive: 2 apartamente banimi në lagjen “10 Korriku”; 2 ambiente shërbimi-dyqan, në lagjen “Pa-

varësia”, 2 vende parkimi në lagjen “Pavarësia”; 6 garazhe të ndryshme në lagjen “10 Korriku” si dhe automjet tip “BMW”. Sipas bluve, dyshohet se pasuritë e sekuestruara janë përfituar si pasojë e veprimtarive të shtetasit J.J. në fushën e prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike. Policia e Shtetit po vijon punën për gjurmimin, evidentimin dhe sekuestrimin e aseteve që rrjedhin nga veprimtari kriminale.

SHKURT

Ekstradohet nga Holanda anëtar i grupit “Bajri”

TIRANË - Samet Halluni, anëtar i grupit të strukturuar kriminal “Bajri” është ekstraduar nga Holanda drejt Shqipërisë. Interpol Tirana në bashkëpunim me Interpol The Hague/Hollandë ekstradoi nga Amsterdami drejt Shqipërisë 21-vjeçarën nga Shkodra, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar. Gjykata për Krime të Rënda Tiranë ka caktuar ndaj të riut masën e sigurisë “Arrest në burg” për veprën penale: “Shtërngim për dhënie pasurie me anë të kanosjes ose dhunës, kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit kriminal”. Sipas policisë, Samet Halluni është anëtar i grupit të strukturuar kriminal “Bajri” dhe dyshohet që në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të këtij grupi ka kanosur me anë të shtërngimit për dhënie e pasurisë një sërë biznesesh në Shkodër duke përfituar prej tyre para dhe pronë.

Të dënuarit grevë urie, reagon AP: Burgu i Burrelit të mbyllet

BURREL - Pas hapit që 18 të dënuar në burgun e Burrelit ndërmorën për t'u futur në grevë urie për shkak të kushteve të këqija në këtë institucion të vuajtjes së dënimit, ka reaguar Avokati i Popullit. Përmes një njoftimi për shtyp, AP sqaron se ekipi i këtij institucioni ka arritur të sigurojë dëshminë e këtyre të dënuarve që po refuzojnë ushqimin. Institucioni i Avokatisë të Popullit bën me dije se prej të paktën tre vjetësh janë konstatuar kushtet e papërshtatshme të këtij institucioni, ndërsa është kërkuar edhe mbyllja e tij. Sipas AP-së, të dënuarit hasen me kushte të vështira dhe aspak të përshtatshme për kryerjen e funksioneve të veta në mënyrë dinjtoze. Ndërkaq, mësohet se të burgosurit kanë refuzuar vaktin e drekës. Por kërkesa e tyre për të hyrë në grevë urie ka hasur në kundërshtimin e drejtorit të këtij institucioni, Fatjon Kurti, i cili ka pohuar se është në negociatë me të dënuarët. “Sapo dola nga qelitet e të burgosurve, jam në negociatë. Ne po punojmë dhe po lyejmë burgun. Nëse duan të futen në grevë urie sipas ligjit, ata duhet të firmosin. Jemi në negociatë”, u shpreh kreu i Burgut të Burrelit.

Tahiri sulmon Andi Bushatin: Analist palaço, gjeti rastin të vjellë banakut

TIRANË

Një ditë pas lënies në burg pa afat të bërë zmesmenit Ervis Martinaj nga Gjykata e Apelit të Tiranës dhe një javë nga dënimi me 55 vjet burg në total për Emiljano Shullazin dhe anëtarët e bandës së tij, ka reaguar Ambasada e SHBA-ve në Tiranë. Në një postim të bërë dje publik në "Facebook", thuhet se pret një hetim të plotë nga drejtësi shqiptare për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri si dhe Ervis Martinajn. Ky i fundit, i përfshirë në ngjarjen në ish-Blok më 4 tetor të këtij viti, ku pas një shkëmbimi zjarri mbeti i vrarë Fabian Gaxha dhe u plagos vetë Martinaj si dhe shoku i tij, Eljon Hate.

DEKLARATA E AMBASADËS SË SHBA

Në postimin e ambasadës amerikane thuhet: "Gjykata e Krimeve të Rënda të Shqipërisë dënoi Emiljano Shullazin dhe grupin e tij, por presim përparim të vazhdueshëm në rrugën e Shqipërisë drejt sundimit të fortë të ligjit. Dje, Gjykata e Apelit të Tiranës dëgjoi argumentet e prokurorëve lidhur me masën e sigurisë për Ervis Martinajn. Ne presim hetimin e plotë të tij, ashtu siç presim që sundimi i ligjit të zbatohet gjatë hetimit në vazhdim për Saimir Tahirin. Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara ndaj së ardhmes së Shqipërisë". Pavarësisht se më 5 tetor të këtij viti Gjykata e Katanas në Itali mbylli çështjen në ngarkim të Saimir Tahirit për akuzën e trafikut të drogës me grupin "Habilaj", ambasada e SHBA-ve kërkon hetim të plotë në Shqipëri për ish-ministrin e Brendshëm, duke insistuar për zbatimin e ligjit. Referuar vendimit të gjykatës së vendit fqinj, rezultoi që Saimir Tahiri ka qenë në hetim nga prokuroria italiane prej datës 27 tetor të vitit të kaluar nga prokuroria e Katanas me akuzën e trafikut të drogës mbi bazën e përgjimeve të çështjes "Habilaj". Në përgjime flitej për 30 mijë euro që grupi "Habilaj" kishte për t'i dhënë një personi me emrin Saimir dhe bizhuteri gruas së tij. Pas hetimeve prej më shumë se një viti, prokuroria e vendit fqinj shkruan se nuk ka gjetur prova që implikojnë ish-ministrin e Brendshëm shqiptar, duke kërkuar arkivimin ose mbylljen e çështjes. Vendimi është marrë nga Gjykata e Hetimeve Paraprake në tetor, ndërsa çështja në ngarkim të Habilajve vijon në Katania, pasi hetimi për Tahirin ishte i veçantë. Por, mbyllja e hetimeve nga pala italiane nuk u jep fund "telasheve" të Saimir Tahirit me drejtësinë shqiptare. Kjo për faktin se ambasada e SHBA-ve këmbëngul që çështja në ngarkim të tij të hetohet deri në fund nga autoritetet shqiptare. Më 14 nëntor të këtij viti, në një reagim tjetër të Ambasadës së SHBA-ve që erdhi pas dënimit me 14 vjet burg të Emiljano Shullazit, ndër të tjera thuhet: "Ne u inkurajojmë nga puna e prokurorëve shqiptarë, të

Ambasada e SHBA: Pas Martinajt, të zbatohet sundimi i ligjit për Saimir Tahirin

Reagon ish-ministri i Brendshëm: Nuk besoj kurrë se jeni kthyer në prokurori a gjykatë. Po flisni më shumë se unë



Deklarata e Bushatit

Analisti Andi Bushati komentoi dje në rubrikën "Opinion" në "News 24" situatën në vend dhe zhvillimet e fundit. Ai e ka nisur me deklaratën e ambasadës amerikane në Tiranë, në lidhje me proceset ndaj personazheve të botës së krimit, por edhe ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. "Lajmi i këtij njoftimi të ambasadës është përmendja e Saimir Tahirit. Në qoftë se në çdo vend normal një ambasada do bënte një paralajmërim me emra, do ishte jo normale. Ambasada amerikane me sa duket po ndihet 50% fajtoare, sepse është autorja protektorja e reformës në drejtësi. Një reformë që po ngjall zhgënjim tek shqiptarët. Rasti i Saimir Tahirit është një nga margaritarët e kurorës së këtij zhgënjimi", deklaroi Bushati.



Prokuroria e Katanas mbylli hetimet, Rama: Saimir Tahirit duhet t'i kërkonte fajle!

Disa ditë më parë, kryeministri Edi Rama, i ftuar në emisionin "Real Story" në "Vizion Plus" ka folur për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri duke theksuar se opozita duhet t'i kërkojë fajle për të gjitha shpifjet dhe baltën që ka hedhur ndaj tij. "Tani që drejtësia italiane dha verdiktin për pafajësinë e tij edhe media duhet të bëjë të njëjtë gjë", tha Rama. Gjithashtu, ai foli edhe për largimin e Xhafajt, ku pohoi se Xhafaj u largua me dëshirën e tij. "Nuk kërkoj fajle për Saimir Tahirin dhe as për Fatmir Xhafajin jo e jo. Jeni ju që duhet t'i kërkonte fajle Tahirit që



kërkuat arrestimin mbi llafet e dy kriminelëve. Tani prokuroria italiane, nga më jakobinët në Europë dhe që bëri hetimet më të thella dhe që gjykata italiane i dha Saimir Tahirit pafajësinë e plotë për atë llum kazan. Si i bie tani që ne nuk lejuam që ai të mos arrestohej? Ta

hiri është nën hetim për pjesë të procesit në Shqipëri dhe ne presim. Ju tani duhet t'i kërkonte fajle Tahirit për akuzat që hodhë për akuzat e prokurorisë së Katanas. Të kërkoj fajle për Tahirin? Pse? Se dy havjanë bënin llogje në telefon. Pse iku Xhafaj? Është vendim sovran i tij. Fatmir Xhafaj e kreu detyrën e tij dhe sot Sandër Lleshi do të bëjë një hop tjetër cilësor. Ai dha dorëheqjen vetë. Ta refuzojë? Pse ta refuzojë? Nga jeta ime sportive kam edhe një mësim. Lojtari që thotë dua të dal nga fusha nuk ka pse të rrijë më në fushë. Ai le të rrijë në stol", tha kryeministri Rama.

në vendin tonë, ndaj e përsëritës prononcimin me besimin se duam e presim të njëjtën gjë, drejtësia të bëjë drejtësi!"

REAGIMI I TAHIRIT

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri ka reaguar pas deklaratës së ambasadës amerikane në Tiranë, ku përmendej edhe emri i tij. Në një postim në "Facebook", Tahiri thekson se ambasada amerikane ka folur për hetimet e tij më shumë se ai vetë. "Siç nuk duhet të ndodhte në një vend normal, për fat të keq ka ndodhur që ambasada amerikane ka folur për hetimin ndaj meje më shumë se ç'kam folur unë vetë. Ndodhi sërish edhe sot! Ndërsa ky lapsprishuri, e gjeti rastin e radhës të vjelli banakut duke më bërë mua simbolin e dështimit të reformës në drejtësi. Reformës në drejtësi në



Gjykata e Fierit "rrezon" Zaganin, dënohet me 4.6 vite burg në mungesë për shpërdorim detyre

FIER - Ish-shefi i Antidrogës në Drejtorinë Vendore të Policisë së Fierit, Dritan Zaganin, i cili aktualisht është azilant në Zvicër është shpallur fajtor nga Gjykata e Shkallës së Parë e Fierit. Togat e zeza të këtij qyteti e kanë dënuar atë me 4.6 vite burg për akuzat e "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Moskallëzimit të krimit". Sipas togave të zeza të Fierit, Zaganin ka dëmtuar hetimet e policisë dhe ka vepruar për interesa private dhe për përfitime monetare nga policia italiane (për bashkëpunim pa autorizim me një oficer të Guardia Di Finanzia, të cilit u jepte informacion, përkundrejt pagesave në euro). Në argumentimin e vendimit thuhet se në vitin 2014, Zaganin është bërë shkak i prishjes së një aksionin kundër trafikantëve të drogës që po ndiqte nga Krimet e Rënda dhe nga agjentët të Policisë së Shtetit, ku synimi i tyre ishte bluzimi i të gjithë anëtarëve të grupit. Ky aksion u ndërpre në mes atëherë, pasi në Fier ka ndërhyrë Zaganin, në atë kohë shef antidroge. Ky është dënimi i dytë për Zaganin, pasi një vit më parë Gjykata e Shkallës së Parë në Vlorë e ka dënuar atë me 3 vite burg për akuzën: 'Largimi nga vendi i qëndrimit të detyruar'. Dritan Zaganin u la nga gjykata në masën e sigurisë 'Arrest shtëpie', por ai u arratis. Çështja e tij mori të tjera përmasa politike dhe mediatike, kur u largua në Zvicër. Ish-oficeri i policisë, Dritan Zaganin, hodhi akuzat të forta, ndërsa deklaroi se politika në Shqipëri është e inkriminuar deri në palcë.

Ditën e nesërme, studentët e universiteteve publike në vend do të protestojnë për uljen e tarifave të detyrueshme dhe rritjen e buxhetit për universitetet. Nën sloganin "Ulni tarifën, rritni buxhetin" ata do të marshojnë drejt Kryeministrit, në vazhdim të aksioneve të herëpashershme që kanë ndërmarrë lidhur me këtë kauzë. "Studentët ndihen të zhvatur kudo dhe çdo ditë. Zhvaten përmes tarifave nga më të lartat në Evropë, të cilat priten të rriten edhe më kur qeveria të nisë shpërndarjen e parave publike drejt universiteteve private. Zhvaten nga çmimet abuzive të librave, nga kostot e larta të jetesës dhe ëndrra për t'u punësuar profesionalisht pas studimeve", thonë ata në thirrjen e tyre. Sipas studentëve, puna si kamerierë

Nesër protestë para Kryeministrit për uljen e tarifave

Studentët: Zhvatja nga Fakulteti i Shkencave, 700 euro për një provim

TARIFAT

"Prej vitesh FSHN është kthyer në një celulë të mirë-strukturuar zhvatjesh studentore, ku ka pedagogë që kërkojnë deri në 700 euro për një provim, që shesin libra me listë dhe i detyrojnë studentët të bëjnë kurse private për të kaluar provimet, etj. Nëse shtojmë këtu edhe tarifën e studimit dhe koston e jetesës, mund të themi se jeta e studentit është kthyer në një ferr të vërtetë"

dhe thirrës telefonikë është e tashmja dhe i vetmi horizont që iu paraqitet e më tej theksojnë se zhvaten nga klasat e ftohta, bibliotekat e ngushta, pedagogët abuzues dhe shpërfillja e drejtuesve universitarë. Tri kërkesat kryesore që të rin-

jtë i drejtojnë qeverisë janë: përgjysmim i të gjitha tarifave studimore; rritje serioze e buxhetit të shtetit për universitetet publike; si dhe themelimi i një entit botues publik që boton libra universitarë me çmim të lirë. "Zëri i studentëve, që do të

duhej të ishte gjithçka, nuk dëgjohej nga askush. Për ta lartësuar zërin tonë, për të mbrojtur të drejtat tona dhe ndërtuar skelën e shpresës për një universitet më të mirë e demokratik, ku studimet kushtëzohen vetëm nga merita, e jani të mblidhemi si kurrë më parë në marshimin e protestës! Studentë, pedagogë të përgjegjshëm dhe qytetarë të shqetësuar për fatet e arsimit! Bashkohemi të enjten në orën 10.30 te Korpusi dhe marrim rrugën drejt kryeministrit! Nuk ka forcë në botë që ndal studentët e bash-



kuar", -theksojnë ata në thirrjen e tyre. **AKSIONI** Sakaq, ditën e djeshme studentë dhe aktivistë të Lëvizjes për Universitetin zhvilluan në Fakultetin e Shkencave të Natyrës një aksion simbolik për uljen e tarifave dhe kundër zhvatjes së studentëve. "Prej vitesh FSHN është kthyer në një celulë të mirë-strukturuar

zhvatjesh studentore, ku ka pedagogë që kërkojnë deri në 700 euro për një provim, që shesin libra me listë dhe i detyrojnë studentët të bëjnë kurse private për të kaluar provimet, etj. Nëse shtojmë këtu edhe tarifën e studimit dhe koston e jetesës, mund të themi se jeta e studentit është kthyer në një ferr të vërtetë", thonë studentët. **vo. du.**

Europol: Djem të rinj të moshës 12 - 15 vjeç detyrohen të lajnë makina pa pagesë

Voltiza Duro

Dita e të Drejtave të Fëmijëve, raporti: Mbi 5 mijë të mitur shqiptarë, të trafikuar

Hazizaj: Shfrytëzohen për prostitucion dhe shitje droge

Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, statistikant mbi trafikimin e të miturve në Shqipëri rezultojnë tejet tronditëse. Sipas të dhënave nga raportet zyrtare të shteteve të BE-së dhe të organizatave ndërkombëtare përllogarisin se janë mbi 5000 fëmijë të trafikuar, të kontrabanduar dhe të pashoqëruar nga Shqipëria. Megjithatë edhe këto të dhëna duken të pjesshme, po të krahasojmë të dhënat e raportuara nga Mbretëria e Bashkuar, ku vetëm gjatë dy viteve të fundit janë raportuar më shumë se 1500 fëmijë nga Shqipëria të trafikuar dhe kontrabanduar drejt këtij shteti, shumica e tyre fëmijë-vajza. Në raportin e Europol theksohet se grupet kriminale shqiptare, trafikojnë djem të rinj në moshën 12 deri në 15 vjeç në BE dhe më pas i detyrojnë ata të punojnë në lartësi e makinave pa pagesë. Fëmijët jepen nga familjet e tyre në Shqipëri dhe Kosovë, të cilët i paguajnë kontrabandistëve rreth 10,000 euro, me premtimin që fëmijës së tyre do ti jepet një e ardhme më e mirë në BE. Të miturit transportohen ilegalisht në Evropën Jugore dhe më pas udhëtojnë përmes ajrit dhe detit në Evropën Perëndimore. Ky rrjet kriminal ka njësi të vendosura në shtete të ndryshme anëtare të BE-së, duke përfutur nga pagesa paraprake e familjeve, por edhe nga shfrytëzimi i punës së të miturve.

"Disa rrjete kriminale evroponin në disa vende të BE njëkohësisht dhe disa të dyshuar ishin regjistruar tashmë në bazat e të dhënave kriminale të BE-së në lidhje me përfshirjen e tyre në krimin e pronës, prodhimin e drogës dhe trafikimin, prostitucionin e detyruar dhe



Foto ilustruese

5 000 FËMIJË

Sipas të dhënave nga raportet zyrtare të shteteve të BE-së dhe të organizatave ndërkombëtare përllogarisin se janë mbi 5000 fëmijë të trafikuar, të kontrabanduar dhe të pashoqëruar nga Shqipëria. Sipas të dhënave të raportuara nga Mbretëria e Bashkuar, janë raportuar më shumë se 1500 fëmijë nga Shqipëria të trafikuar dhe kontrabanduar drejt këtij shteti.

kontrabandimin e emigrantëve. Në shumicën e këtyre rasteve familjet e viktimave u përfshinë në procesin e trafikimit në nivele të ndryshme, ndonjëherë me vetëdije duke bërë dorëzimin e fëmijëve të tyre ose nganjëherë duke mos qenë në dijeni të rrezeve të shfrytëzimit të fshehur pas një shërbimi kontrabande", -thekson

Altin Hazizaj, drejtor i organizatës për të drejtat e fëmijëve, CRCA Albania. Ky i fundit shton se viktimat e vogla të shfrytëzuara në prostitucion në BE u larguan nga vendi i tyre i origjinës në të njëjtën kohë me viktimat e tjera të rritura. Hazizaj thekson se një grup shqipfolës thuhet se planifikonte rrëmbimin e vegjëlve për të rreg-

ulluar birësimet e paligjshme. Një prej shqetësimeve të veçanta në lidhje me këtë rrjet ishte dimensiononi gjeografik i grupit, pasi të dyshuarit u gjetën të jenë në kontakt me njerëz në disa vende të BE-së, Indi dhe Vietnam që organizojnë skema potenciale të adoptimit ilegal. "Sipas Qendrës "Vatra", vetëm gjatë vitit 2017 ka patur 44 raste të reja, rreth 30% më tepër krahasuar me një vit më parë. Nga këto, rreth 59% e rasteve përdoren për shfrytëzim seksual, ndërsa 41% e tyre për shfrytëzim për lypje, etj. Raporti i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit, ndau shqetësimin kryesor të ngritur edhe nga CRCA Shqipëri, se "trafikantët gjithnjë e më shumë po përdorin mediat sociale për të rekrutuar viktimat. Fëmijët shpesh detyrohen të lypin ose të kryejnë lloje të tjera të punës së detyruar. Qeveria shqiptare raportoi më pak ndjekje penale dhe gjykime dhe autoritetet vazhduan të hetojnë dhe ndjekin penalisht disa trafikantë për krime të vogla si shfrytëzimi i prostitucionit", -thekson Hazizaj.

Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, kryebashkiaku Erion Veliaj organizoi një takim me Këshillin e Fëmijëve, nxënësit e të gjithë shkollave të kryeqytetit dhe përfaqësues të UNICEF-it. Ata diskutuan së bashku mbi disa projekte të veçanta të bashkisë, si ajo për ndërtimin e rrjetit të korsive të dedikuara për biçikletat. Ai nënvizoi se fokusi i bashkisë është edhe ndërtimi i 11 km të tjera të korsive. "Një nga gjërat që do të bëjmë është se do të shtojmë edhe këtë vit 11 km korsori biçikletash. Një nga gjërat që do të bëjmë është

Të drejtat e fëmijëve, kryebashkiaku Veliaj takim me nxënësit e kryeqytetit



vendosja e parkingjeve të biçikletave nëpër shkollë. Për ata që janë në distanca

të afërta të kenë mundësi që të përdorin biçikletën. Dua shumë që të inkurajojmë edhe prindërit. Në shumë prej rrugëve kryesore i kemi dhënë më shumë prioritet biçikletave se sa makinave", deklaroi ai. Kreu i bashkisë prezantoi dhe projektin e ndërtimit të shkollave të reja. Veliaj nënvizoi se shkollat e reja, por edhe ato ekzistuese, të shërbejnë si shkolla komunitare. Ndër-

kaq, kryebashkiaku Veliaj ftoi të gjithë fëmijët që ti bashkohen nismës së re, për vendosjen e një flamuri shqiptar në ballkonet e shtëpive të tyre, tani që po afrohen festat e 28-29 Nëntorit. Gjithashtu, ai kërkoi që nxënësit e kryeqytetit të bëhen pjesë e aksioneve vullnetare për pastrimin e mbetjeve, duke kontrabuar drejtpërdrejt në mbajtjen pastër të ambientit.



Dje gjatë leksionit të hapur në universitetin "Luarasi"



Dekani i fakultetit të ri, Baholli: Tradita jonë do të vijojë gjatë gjithë vitit akademik

Studentët e universitetit "Luarasi", leksion me ekspertin e tekonojgjisë

Voltiza Duro

Universiteti "Luarasi" në kuadër të ndërthurjes së teorisë me praktikën, vazhdon traditën e zhvillimit të leksioneve të hapura me profesionistët më të mirë në treg. Këtë të martë, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, Besmir Semanaj, ekspert dhe menaxher në kompaninë e telekomunikacionit Albtelcom trajtoi tema të ndryshme mbi teknologjinë me studentët e vitit të parë Bachelor dhe iu shpjegoi të rinjve sesi të bëhen profesioniste të suksesshëm në tregun e punës së teknologjisë, i cili kërkohet çdo ditë e më shumë. Eksperti i teknologjisë, Besmir Semanaj tregon se studentët shfaqën interes gjatë gjithë orës së leksionit të hapur. Ai shprehet i kënaqur mbi faktin që 'Luarasi' nuk garanton vetëm diplomën në përfundim të studimeve, por formon profesionistë të aftë në tregun e punës. "Sot në Shqipëri ka jashtëzakonisht nevojë për inxhinierë të teknologjisë së informacionit duke filluar nga kompania ku unë punoj e të gjitha kompanitë. Kam shumë shokë e miq që kërkojnë referenca për persona të aftë për tregun e punës. Takimi me studentët e staf akademik kaq të mrekullueshëm, siç ka 'Luarasi' me të vërtetë ishte një kënaqësi. Çdo gjë shkoi jashtëzakonisht mirë. Studentët ishin shumë të interesuar, çka tregon se me të vërtetë janë studentët që mendojnë për të ardhmen, dhe kanë përzgjedhur këtë universitet që të dalin dikushi në jetë të nesërmen e afërt. Më bëhet qejfi që ka universitete të tilla, të cilët jo thjesht pranojnë studentët, iu shpejgojnë kurrikulat e miratuara, por përpigjen të zgjerojnë horizontin e tyre", tha Semanaj.

Semanaj: "Luarasi" formon profesionistë, stafi i mrekullueshëm



Eksperti i teknologjisë, Besmir Semanaj, dje në universitetin "Luarasi"

PRAKTIKA NË 'LUARASI'

Ndërkohë, dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit në "Luarasi", Indrit Baholli thekson se nëpërmjet praktikave të tilla studentët përfitojnë më së miri për tregun e punës. Ai shton se leksionet e hapura do të vijojnë përgjatë gjithë vitit akademik, duke ofruar për studentët eksperiencat më të mira. "Leksioni pati goxha interes nga ana e studentëve, pasi pashe pritshmëritë e tyre në fund. Ne si Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit do të vijojmë më tej, pasi i shohim me shumë vlerë këto loj leksionesh që ndërthurin teorinë me praktikën. Është shumë e rëndësishme për studentët që të shohin konkretisht se çfarë ndodh në praktikë, kështu ata përfitojnë akoma më mirë për të ardhmen e tyre", u shpreh dekani. Nëpërmjet praktikave të tilla bash-

këkohore, 'Luarasi' vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në vend duke sjellë përvojën më të mirë ndërkombëtare pranë studentëve e duke prezantuar modele suksesi që i japin më shumë guxim e orientim për të ardhmen.

FAKULTETI I RI

Për herë të parë Luarasi

terin profesional për Sigurinë Kiberetike dhe Informacionin si dhe Masterin shkencor për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit. Këto programe kanë për qëllim të sigurojnë një lidhje organike mes teknologjisë së informacionit dhe biznesit. Në mbarim të këtij cikli të diplo-

edhe njëherë se ky institucion elitari i arsimit të lartë i afrohet çdo ditë e më shumë nevojave të tregut me programe studimi që sigurojnë punësim në të ardhmen. "Luarasi" synon të ofrojë këtë vit të ri akademik dhe programe studimi në fushën e teknologjisë së informacionit (dy programe bache-



PRAKTIKAT

Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit në "Luarasi", Indrit Baholli thekson se nëpërmjet praktikave të tilla studentët përfitojnë më së miri për tregun.

teknologji informacioni dhe inovacioni), nëpërmjet Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit & Inovacionit, çka përbën një risi në tregun e IAL-ve private në Shqipëri. Disa kohë më parë, studentët e vitit të parë në nivelin Bachelor të këtij fakulteti janë njohur me akademinë Mikrotik. Kjo akademi do të ofrojë kombinimin e teorisë me praktikën si dhe gasjen e studentëve me bizneset që operojnë në fushën e teknologjisë. Akademia Mikrotik do t'u vijë në ndihmë të gjithë studentëve që të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit në universitetin Luarasi që të praktikojnë njohuritë sipas një programi që aplikohet në shumë universitete prestigjioze në mbarë botën.

LEKSIONET E HAPURA

Disa ditë më parë, Universiteti "Luarasi" priti edhe menaxherin mitik të librarive "Feltrinelli", personalitetin e shquar italian, Romano Montroni. Studentët e Fakultetit Ekonomik patën mundësinë e artë për të ndjekur leksionin e hapur mbi teknikat bashkëkohore të menaxhimit dhe marketimit të librit. Gjatë bashkëbisedimit me studentët, Montroni prezantoi veprën e tij "Të shesësh shpirtin zanati i librarisë" për të përcur përvojën e tij më të mirë tek të rinjtë e "Luarasi". Miti i librarëve italianë u përpoq të tregonte edhe njëherë vlerën e jashtëzakonshme të librit në formimin arsimor, kulturor e vetë jetën e një kombi. Në aktivitetin, ishte e pranishme edhe drejtoresha e Institutit Italian të Kulturës, Alessandra Malgarini.


VLERESIMI

"Çdo gjë shkoi jashtëzakonisht mirë. Studentët ishin shumë të interesuar, çka tregon se me të vërtetë janë studentët që mendojnë për të ardhmen dhe kanë përzgjedhur këtë universitet që të dalin dikushi në jetë të nesërmen e afërt. Më bëhet qejfi që ka universitete të tilla, të cilat jo thjesht pranojnë studentët, iu shpejgojnë kurrikulat e miratuara, por përpigjen të zgjerojnë horizontin e tyre", - tha Semanaj.

do të ofrojë programe jo vetëm për ciklin të parë të studimeve Bachelor në fushën e teknologjisë, por edhe në ciklin e dytë master. Për vitin e ri akademik 2018-2019, universiteti do të ofrojë mas-

muarit do të kenë mundësi jo vetëm të identifikojnë nevojat e biznesit, por të propozojnë edhe zgjidhje mbështetur në këto teknologji të kohës. Kjo risi në universitetin "Luarasi" dëshmon

lor në informatikë ekonomike dhe teknologji informacioni dhe inovacioni, dhe dy programe Master: Master Profesional në siguri kibernetike dhe e informacionit, si dhe Master i Shkencave në

 Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

FOR CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I RECONSTRUCTION OF TAXIWAYS B, W AND W2 TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for reconstruction of TAXIWAYS B, W AND W2.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist of: demolition of existing pavement taxiway structures, soil removal and excavations, drainage works, full construction of taxiways, reconstruction of taxiways, airfield lighting and all required installation and connection works.

To participate in this process interested parties will need to retrieve the Invitation to Tender and Confidentiality Commitment Document together with the respective forms, which can be retrieved at Tirana International Airport premises, Administration Building, Rinas, until 23 of November 2018.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I"

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 December 2018.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com


 **BLUE TOOTH**

THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta

Vipave

me të ardhura të tilla me
GAZETA SHQIPTARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË GJYKATA E LARTË

Rr: "Ibrahim Rugova", Tiranë, Shqipëri, www.gjykataelarte.gov.al Telefoni/Fax: +355 257308

N J O F T I M

Sipas nenit 125 të Kushtetutës (e ndryshuar), nga 9 (nëntë) anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Në zbatim të këtij detyrimi kushtetues dhe bazuar në pikën 3 të nenit 9, të Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me ligjin nr. 99/2016), me shkresën nr. 354, datë 27.09.2018, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka njoftuar Kryetarin e Gjykatës së Lartë për krijimin e një vendi vakant në Gjykatën Kushtetuese, si rezultat i largimit të gjyqtarit Fatmir Hoxha, në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve.

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, ky vend vakant i krijuar në Gjykatën Kushtetuese, është emërtuesë e Gjykatës së Lartë. Pra, zgjedhja e këtij anëtar do bëhet nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, **rishpall** hapjen e procedurës së aplikimit të kandidatëve që dëshirojnë të konkurrojnë për këtë vend vakant.

Afati i pranimit të kërkesave të kandidatëve, sipas nenit 7/ç të Ligjit të sipërpërmendur, është 30 ditë nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Mbas kalimit të këtij afati, dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët do t'i përcillet Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili është organi kompetent për vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të emërimit të kandidatëve. Mbi bazën e këtij vlerësimi, ky Këshill bën edhe renditjen e kandidatëve.

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese sipas neni 7/a të

ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) janë si vijon:

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- d) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- e) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- f) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
 - b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
 - c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.
3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
- a) vjetërsisë në profesion;
 - b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
 - c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
 - d) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
 - e) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
 - f) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

Në përfundim të afatit të paraqitjes së kërkesave, lista me emrat e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Kjo bëhet në zbatim të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me qëllim që institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë të mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Thaçi: Na e mohuan padrejtësisht. Duhet të arrijmë marrëveshjen

Mospranimi në INTERPOL, Prishtina: Faj i Serbisë

Haradinaj: Dëshmuar sërish karakterin kundra nesh

Bekim Shehu

Drejtesit e institucioneve të Kosovës thonë se mospranimi i Kosovës në INTERPOL është humbje për Kosovën dhe Serbinë. Por qeveria në Beograd e cilëson mosanëtarësimin si fitore të Serbisë. Qeveria e Kosovës shprehu zhgënjimin e saj të thellë që Asambleja e Përgjithshme e INTERPOL-it votoi kundër anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare të bashkëpunimit policor, që lufton krimin transnacional. Për këtë dështim, qeveria e Kosovës fajin e hedh tek Serbia. Kryeministri Haradinaj thotë se, "Serbia bëri fushatë të egër kundër anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL".

REAGIMET NGA KOSOVA

"Fushata e egër e Republikës së Serbisë dëshmoi edhe njëherë karakterin e saj kundër Kosovës dhe kundër idesë për normalizim të raporteve me Republikën e Kosovës, aq më parë, kur ky anëtarësim ishte teknik dhe jo politik. Votimi kundër pranimit të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare i bën shërbim vetëm krimin dhe kriminelëve dhe askush nuk do të duhej t'i gëzojë këtij fakti", thotë në reagimin e parë kryeministri Ramush Haradinaj. Sipas tij, "gjatë gjithë kohës së përpjekjeve të Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë, diplomacia e Serbisë ishte angazhuar në kundërlobim për të penguar këtë anëtarësim". Edhe Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi tha se, "mosanëtarësimi i Kosovës në INTERPOL është humbje edhe për Kosovën edhe për Serbinë". "Kjo gjë iu mohua padrejtësisht Kosovës, por në të njëjtën kohë duhet të arrijmë marrëveshjen përfundimtare me Serbinë, përndryshe do të humbasim të dy vendet duke e penguar njëra-tjetrën në procese", shkroi Presidenti Thaçi. Dëshmtim e Kosovës që të pranohet në INTERPOL, ministri i Punëve të Brendshme i Qeverisë së Serbisë, Nebojsa Stefanoviçin.



Daçiç: As Kurzi nuk ju ka ndihmuar

Serbia "feston" mospranimin e Kosovës në INTERPOL

Presidenti Aleksandar Vuçiç u shpreh i kënaqur me "fitoren e madhe diplomatike të Serbisë". Ai foli për një "fitore të vogël ndaj fuqisë së madhe". Njëkohësisht ministri i Jashtëm, Ivica Daçiç tha se "kjo është një fitore e madhe e Serbisë dhe dëshmi se me dhunë nuk mund të bëhet asgjë". Daçiç në veçanti nënvizoi mbështetjen e kancelarit austriak Sebastian Kurz për anëtarësimin e Kosovës në Interpol, të cilët ai e sheh si një "tradhëti mik madhe të popullit mik austriak". "As Kurzi nuk ju ka ndihmuar", theksoi Daçiç (Kjo fjali e Daçiçit



mund të ketë edhe një kuptim tjetër, sepse bëmëri i kancelarit austriak ne gjuhët sllave ka edhe një kuptim tjetër, vërejtje e autorit). "Kurzit i kam

thënë: Ti je bre njeri i mençur, po cili budalla do të dilte në anën e humbësit. Edhe Christian Strache (zv/kryeministër i Austrisë) duhet t'u sqarojë serbëve se pse e ka gënjyer popullin serb. As Kurz nuk është më i mirë. Mendoj se ai është edhe më i keq", ka thënë Daçiç. Serbia beson se pas këtij dështimi në Interpol është foruar pozita e saj negociatore karshi Kosovës. Por ajo ka frikë se Kosova mund të forcojë kokëfortësinë e saj në këtë proces, sepse Kosova mund të jetë e frustruar pas këtij votimi dhe të ndërmarrë aksione të papritura.

ovës përkundër fushatës, të udhëhequr nga Serbia, për t'u bërë presion vendeve për ta kundërshtuar kërkesën e Kosovës". "Të dyja palët duhet t'i shpejtojnë përpjekjet për marrëveshjen. Mbështetja për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL kurrë nuk ka qenë për pranimin e pavarësisë së Kosovës, por për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar

ndërmarrë aksione të papritura.

TAKSA

Kosova i ka vënë Serbisë një taksë prej 10% në mallrat serbe që importohen atje, sikur edhe Bosnjë-Hercegovinës. Por ajo ka shkruar edhe një hap më larg duke ndaluar importimi e mallrave, në të cilat shkruan "Kosovo UNMIK", "Kosovo i Metohija", ose "Kosovo UN 1244". Në Prishtinë është paralajmëruar se do të krijohet edhe ushtria e këtij vendi, thotë analisti Boshko Jakshiq, e kjo mund të sinjalizojë një pikë tjetër konflikti mes Beogradit dhe Prishtinës.

SHKURT

Sulm me armë në spital, vdesin 4 veta

Katër persona humbën jetën në një sulm me armë në një spital në Çikago të Shteteve të Bashkuara. Mes viktimave është edhe agresori, dy punonjëse të spitalit dhe një polic. Autoritetet dyshojnë se agresori pati fillimisht një zënkë me njërin nga viktimat, me të cilën mund të ketë pasur edhe një marrëdhënie dashurore. Megjithatë, motivet e sulmit nuk janë zyrtarizuar ende.

Aksidenti me makina në Kinë, vdesin 9 veta

Një aksident në të cilin u përfshinë 28 makina u mori jetën të paktën 9 personave, ndërsa 9 të tjerë mbetën të plagosur. Ngjarja e rëndë ndodhi mëngjesin e së hënës pranë një stacioni të tarifimit të rrugës, në një autostradë në Kinën Qendrore. Autoritetet atje thanë se shkak i këtij aksidenti të rëndë dyshohet se u bë mjeçulla e dendur që përfshiu zonën parritur.

Zjarret në shtetin e Kalifornisë,

1000 të zhdukur

Autoritetet në shtetin e Kalifornisë thanë se ishin në gjendje të përcaktonin vendndodhjen e rreth 300 njerëzve të tjerë, pas zjarrit të madh që përfshiu qytetin e tyre Paradise, më vdekjeprurësi në historinë e këtij shteti. 1,000 njerëz ende rezultojnë të zhdukur, ndërkohë që ekipet e shpëtimin vazhdojnë të kërkojnë nëpër rrënojat e ndërtesave të djegura dhe të përpigjen të kontaktin me personat që raportohen të zhdukur. Numri zyrtar i vdekjeve u rrit dje në 77. Zyrtarët thanë se autoritetit kanë identifikuar 67 prej tyre.

Ish-kryetari i

Nju Jorkut dhuron 1.8 mld dollarë

Ish-kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, Michael Bloomberg, njoftoi se po i dhuron 1.8 miliardë dollarë Universitetit "Johns Hopkins", për të rritur ndihmën financiare ndaj studentëve me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Universiteti në Baltimore të shtetit Maryland tha se kontributi i zotit Bloomberg për shkollën ku ai vetë ka kryer studimet është më i madhi që i është dhënë ndonjëherë një institucioni arsimor në SHBA. Sipas zyrtarëve, me këtë shumë universiteti do të mund të eliminojë kreditë studentore.

Kontabilistë! Sigurimi i jetës është

bilanci më i sigurt i jetës suaj!



Me Sigurimin Jetë me Mbijetesë keni përfitim dyfish: sigurim jete dhe investim afatgjatë. Mbroni pasardhësit tuaj në rast të papriturave dhe njëkohësisht investoni me një normë të garantuar interesi prej 1.2% në vit, në monedhat Lek, Euro ose Dollar. Primi vjetor minimal duke filluar nga 200 euro/vit dhe shumë sigurimi deri në 120,000 euro!



**SIGURIMI
JETË me MBIJETESË**



Sigurim
për Jetën



Sigurim nga
Aksidentet



Sigurim nga
Sëmundjet Kritike



SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: **Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al**

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

**MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ**



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 21 Nëntor 2018 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Mbretëresha e nxehur me veshjet e Meghan, i vendos tri rregulla strikte
- '5 njerëzit e mëdhenj të botës kanë qenë autikë, Hyseni s'e ka atë shans!'
- Pjerin Ndreu, 'selfie' me Dua Lipën në Vatikan: Ishte e gjatë more...
- Ish-kryebashkiaku i dhuron \$1.8 miliardë universitetit ku kreu studimet

Nuk do ta besoni sa para fitojnë disa nga këngëtarët më të njohura shqiptare



Rita Ora i dedikon albumine dytë DJ të ndjerë Avicii



Regjisorja: Nuk bëj palestër, por një herë në ditë i ngjis shkallët në këmbë deri në shtëpi



20 gjërat që nuk i dini për Inis Gjonin: Kam refuzuar 10 oferta për në televizion...

Regjisorja: Nuk bëj palestër, por një herë në ditë i ngjis shkallët në këmbë deri në shtëpi

20 gjërat që nuk i dini për **Inis Gjonin**: Kam refuzuar 10 oferta për në televizion...

Eraldo Rexho

Inis Gjoni është një nga njerëzit e veçantë të këtij vendi, një nga njerëzit që ia dua më shumë këtij qyteti. Dhe unë, megjithëse duket ndryshe, nuk i dua kaq shumë të gjithë të famshmit e këtij vendi. Si të gjithë frymorët e tjerë, bëj edhe unë diferencimet e mia, të cilat sigurisht përpiqem t'i zbuloj sa më pak publikisht, por tek Inisi këtë herë u dorëzo-va, edhe sepse zbulova një cilësi që nuk ia njihja: ajo është shumë e durueshme. I kërkova Inisit të më listonte 20 gjërat që njerëzit nuk i dinë për të dhe ajo ka bërë një rrëfim shumë interesant në vetën e parë, që nuk duhet ta humbim.

1. Prej vitesh, harroj çdo ditëlindje të familjes, përfshirë edhe timen. E vetmja që bën përjashtim, është ditëlindja e Coco Antonel, dita më e bukur e jetës sime.

2. Nuk bëj palestër, por një herë në ditë, i ngjis shkallët në këmbë deri në shtëpi. Dhe unë e kam shtëpinë në katin e tetë.

3. Kur më pëlqejnë një palë këpucë blej tre palë në të njëjtin model dhe ngjyrë. Ti kem, se nuk i dihet (qesh).

4. Nëse nuk do isha marrë me art, do vdisja të bëhesha arkeologe ose shkencëtare. Më pëlqejnë shumë zbulimet.

5. Ka vite që nuk shoh asnjë program ose film në televizion, përjashtoj rastet kur marr ndonjë porosi nga miqtë dhe familjarët. E vetmja gjë që më merr vëmendjen nga ekran janë kukullat e Coco-së dhe dokumentarët. Këto të fundit, mund t'i shoh për orë të tëra dhe të mos mëzitem.

6. Jam një gjumashe e pandreqshme... Do jepja gjithçka që të filja gjumë në mëngjes, por që prej lindjes së Coco kam kohë që nuk e di se ç'do të thotë të fliesh gjumë deri në orën 10. Maksimumi që kam arritur, ka qenë 9-ta (qesh).

7. Deri përpara se të bëhesha nënë dija të gatujta vetëm vezë.

8. Për flokët e mi kujdesem vetëm unë, edhe në parukeri, apo dalje televizive, flokët i kuroj vetë.

9. Kam thyer këmbën kur kam qenë 5 vjeçe dhe doktori në spital ka thënë "sa të drejta i paska këmbët, nëse edhe këmba që ka thyer do të bëhet kaq e drejtë sa këmba tjetër, atëherë këtë vajzë bëjemi balerinë". Atëherë askush nuk e dinte që unë do merresha me balet.

10. Kam shumë histori nga jeta si balerinë; më ka ndodhur që më ka dalë këpuca gjatë kërcimit, që partneri ka këputur mish duke më ngritur në padjeshkë, e të tjera si këto.

11. Kur mbarova shfaqjen e parë si regjisore, isha aq shumë e emocionuar sa nuk i njihja njerëzit që takoja.

12. Ka qenë një rast kur drejtoja Festivalin e Këngës, së bashku me mikun tim Gaz Gjoka, që harrova



pjesën time të tekstit dhe nisa të flisja 'përçart' për të dalë nga situata. Nuk e mbaj mend çfarë kam thënë, por këngëtari e kuptoi që ishte radha e tij (qesh).

13. Besoj se kam qenë ndër të parat vajza në Tiranë që kam drejtuar një automjet, në vitin '96. Unë dhe

Rudina Magjistari, kemi qenë ndër të parat.

14. Çmenduria më e madhe që kam bërë në timon, kam kaluar Llogoranë, natën dhe me mjegull. Zoti ka qenë me mua atë natë.

15. Kam refuzuar mbi 10 oferta për të qenë në ekran vitet e fundit, nuk



e di ç'më ka gjetur, por besoj se dashuria për teatrin po më mban larg televizionit.

16. Me Ingritin nuk zgjat asnjëherë inati. Grindemi tani dhe pas 60 sekondash jemi sërish duke folur.

17. Unë nuk pi kurrë pije me gaz, nuk pi kurrë kafe, jetoj shumë mirë

me ujë dhe qumësht.

18. Nuk lexoj asnjëherë gazeta, me përjashtim të rasteve kur më njoftojnë që kam dalë unë.

19. E urrej jokorrektësinë.

20. Si për fund po ju zbuloj që aktualisht po punoj për një shfaqje të re teatrale.





Këngëtarët shqiptarë janë bërë të famshme në mbarë botën dhe pas famës vjen fitimi që u mundëson të jetojnë një jetë mjaft komode e luksoze. Si gjithmonë ato do thonë se fansat janë dhurata më e mirë nga gjithë ky rrugëtim, por na besoni kur themi se nuk kanë dalë me kaq pak fitim. Faqja e njohur 'online' 'Net worth leaks' tregon pasurinë e gjithë artistëve në mbarë botën, mënyrën e fitimit të parave, e madje llogarit dhe fitimet e çdo viti. Të njëjtën gjë ka bërë dhe për këngëtarët më të njohura shqiptare. Dua Lipa, Rita Ora, Bebe Rexha e së fundmi Era Istrefi me anë të këngeve, koncerteve, eventeve, e promovimeve kanë fituar dhe miliona dollarë. Mes këngëtareve shqiptare më të paguara është Rita Ora me plot 20,500,000 dollarë fitime. Rita përpos muzikës, ka hyrë dhe në rrugën e modës, duke u bërë disa herë bashkëpunëtoresh me firmën e njohur "Adidas", çka i ka sjellë miliona dollarë fitime. Pas Ritës vjen Bebe Rexha me një pasuri prej 11,000,000 dollarësh. Dua Lipa, e cila po ngjitet suksesin shumë shpejt ka një pasuri prej 3,000,000 dollarë. E fundit, por jo më pak e rëndësishme është Era Istrefi me një pasuri prej 2,700,000 dollarësh.

Nuk do ta besoni sa para fitojnë disa nga këngëtarët më të njohura shqiptare



Këngëtarja me origjinë shqiptare, Rita Ora ka promovuar së fundmi albumin e saj të ri, "Phoenix" të cilin ia ka dedikuar mikut dhe bashkëpunëtorit të tij, DJ Avicii. Rita Ora thotë se albumi i dytë i shumëpritur i është kushtuar Avicii, i cili u nda nga jeta pak komë më parë. Këngëtarja 27-vjeçare ka punuar me DJ suedez për këngën e saj "Lonely Together", e cila u lançua në gusht të këtij viti. Ajo ka nderuar producentin e ndjerë, i cili kreu vetëvrasje të dyshuar, duke e përfshirë atë në këngën në albumin e saj të ri "Phoenix". "Dua të nderoj Avicii, duke e bërë këngën 'Lonely Together' pjesë të albumit. Ai ishte një njeri i mrekullueshëm dhe shumë i talentuar. Ne ishim miq shumë të mirë dhe Avicii më ndryshoi jetën. Në një farë mënyre, albumi i është dedikuar atij", tha Ora.

Rita Ora i dedikon albumin e dytë DJ të ndjerë, Avicii

Lori Hoxha është shpërngulur e vetme në Londër për të vijuar studimet e larta, duke lënë në Shqipëri familjen e saj. 25-vjeçares i ka mbërritur ditën e djeshme një pako në shtëpi. Pakoja mbante të shkruar një pusullë nga motra e saj, Sara dhe nipit i vogël, London të cilët i kanë nisur Lorit një dhuratë e një pusullë prekesë, shkruar në gjuhën e Londonit, që për pak javë mbush 2 vjeç. "Tixhja Joji, që të ndihesh më afer shtëpisë! Mami Saja dhe Dondon Bisa", - shihet shkrimi i publikuar edhe në "Instagram" nga Lori, e cila e përplotur shkruan "Ahhh zemra ime", pa e ditur se çfarë ishte dhurata që do e bënte atë të ndihej më pranë familjes dhe shtëpisë së saj. 25-vjeçarja ka zbuluar se në pako fshiheshin disa pako salcë makaronash, që mesa duket janë të preferuarat e saj dhe që i kujtojnë shtëpinë në Tiranë.



London përplot teze Lorin, dedikim surprizë në Londër



Dua Lipa ndezi mbrëmjen me këngën e saj 'Homesick'. Dasha siç ishte paralajmëruar edhe më parë, mbrëmjen e djeshme u mbajt një koncerti në nder të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Në Romë ishin mbledhur emrat më të njohur si Inva Mula, Dua Lipa, Reme Lahaj, Genc Tukiçi, Kledi Kadiu, Olen Çezari, Elhaida Dani, Lorik Cana, Eno Peci dhe Erza Muqolli, artistët që kanë bërë krenarë shqiptarët në mbarë botën me talentin e tyre. Të shumtë ishin artistët të cilët ndanë momente të bukura nga mbrëmja e djeshme dhe ndër to ishte dhe këngëtarja me famë botërore Dua Lipa. Dua Lipa me anë të një postimi në Instagram u shpreh se dashuria për rrënjët dhe origjinën e saj sa vjen i shtohet. Dua ndezi mbrëmjen me këngën e saj 'Homesick'. "Pas një koncerti të bukur për kujtimor për Gjergj Kastrioti-Skënderbeun ku mora pjesë së bashku me shumë artistë të talentuar shqiptarë. Dashuria për rrënjët e mia sa vijnë e rriten edhe më shumë sesa kam menduar. Të thuash jam krenare është nënvlerësim. Çfarë ndjenje", - shkruajti Dua në 'Instagram'.

Dua Lipa: Të thuash se jam krenare për origjinën është pak!

BOULEVARDI

POLITIK

Na merrni seriozisht!

Mbretëresha e nxehur me veshjet e Meghan, i vendos tri rregulla strikte

Meghan Markle ende nuk ia ka marrë dorën si duhet protokollit të familjes mbretërore. Sepse dihet që nuk është aspak punë e thjeshtë! Mirëpo, duket se veshja e Meghan ka irrituar shumë Mbretëreshën Elizabeth. Kjo pasi shija e saj në modë nuk i përshtatet aspak rregullave të pallatit mbretëror. Sipas "DailyMail", Mbretëresha Elizabeth nuk është shumë e lumtur me zgjedhjet e Dukeshës së re. Ndaj i kanë kërkuar të mos vishet më si yll Hollywood-i, por si pjesë e familjes mbretërore. Konkreisht Mbretëresha Elizabeth ka tre ankesa kryesore! Si fillim, Meghan duhet të heqë dorë nga ngjyra e zezë në evente. Sepse nuk ka vdekur njeri që të vajtojë. Se dyti, të ketë kujdes me gjatësinë e fustaneve, pasi një zonjë e familjes mbretërore nuk duhet të tregojë më shumë se ç'duhet. Dhe e fundit, duhet të mbajë në kokë kapelen që i kërkohet në eventet e caktuara, sepse si duket që nuk janë në preferencën e Meghan. Ehhh, Meghan! Nuk është e lehtë të bëhesh pjesë e familjes mbretërore, kështu që, nëse do dashurinë e Mbretëreshës, mos u bind po deshel!



Pjerin Ndreu, 'selfie' me Dua Lipën në Vatikan: Ishte e gjatë more...

Deputeti i PS, Pjerin Ndreu ishte mes të pranishmëve në Romë, në evetin përkujtimor me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriot Skënderbeut. Teksa ndodhej atje Ndreu ditën e djeshme ndau një foto me këngëtarën Dua Lipa. 'Me krenarinë tonë', shkruante deputeti në diçiturë. Mirëpo kjo selfie nuk u ka shpëtuar ndjekësve pa kapur një detaj. Komentuesve u ka tërhequr vëmendjen fakti që deputeti socialist ishte më 'i shkurtër' se këngëtarja. Këtij komenti i është përgjigjur me shaka edhe vetë Ndreu. "Ishte e gjatë more... Mbi taka po",- shkruan ai.



'5 njerëzit e mëdhenj të botës kanë qenë autikë, Hyseni s'e ka atë shans!'

Ka shpërthyer një valë reagimesh kundër deputetit të PS Alket Hyseni, i cili duke dashur të fyejë Berishën ka fyer të prekurit nga autizmi. Hyseni e cilësoi Berishën "plak autik" duke prekur shumë fëmijë e prindërit e tyre, të cilët luftojnë çdo ditë me mendësinë e të paditurve rreth këtij çrregullimi. Sakaq, studiuesi i njohur Erald Kapri sjell pesë emra të mëdhenj të botës, të cilët, gjithashtu, kanë qenë autikë. "Ajnsh-tajni, Darvini, Nikola Tesla, Mikelanxhelo, Bill Gates kanë qenë autikë. Alket Hyseni nuk e ka atë shans. Është debil", shkruan Kapri. Kujtojmë se Hyseni e ndryshoi fjalën "autik" me "i çartur" pas reagimeve të shumta.



Mbretëresha Elisabeta dhe çadrat e saj, një për çdo veshje

Mbretëresha Elisabeta ka një koleksion të madh çadrash të cilat i përdor me veshjet e saj sipas ngjyrës gjatë eventeve zyrtare. Ndryshe nga Kate Middleton dhe Meghan Markle, fashionistja e vërtetë ikonë mbetet ajo, sovranja, që në moshën 92-vjeçare dhe 66 vjet në fronin mbretëror anglez nuk gabon asnjëherë me veshjen. Kostu-met e saj me ngjyra janë zgjedhur me kujdes për të garantuar gjithmonë tërheqjen e publikut. Por ka një detaj të veçantë në veshjet e saj që bie në sy. Çadrat janë gjithmonë të koordinuara me veshjet në rastet kur bie shi. Modelet e zgjedhura nga mbretëresha, transparente dhe me konture me ngjyra kushtojnë 20 paund. Në këtë foto galeri janë disa nga Çadrat e përdorura nga mbretëresha Elisabeta.

Ministria e Drejtësisë në Maqedoni nis kërkesën për ekstradimin: Të zbatohet vendimi i gjykatës

Gruevski: Kam strehim politik në Hungari

Ish-kryeministri i dënuar në Maqedoni: Më përndiqnin politikisht

Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski, i cili u dënua me dy vjet burgim për akuza të lidhura me korrupsionin, konfirmoi të martën se i ishte dhënë strehim politik në Hungari. "Sot Republika e Hungarisë, një shtet anëtar i BE-së dhe NATO-s, iu përgjigj pozitivisht kërkesës sime të paraqitur më parë për të marrë strehim politik për shkak të përndjekjes politike në Republikën e Maqedonisë", shkruante Gruevski në faqen e tij në "Facebook". Ministria e Drejtësisë në Maqedoni ia ka nisur të martën kërkesën Ministrisë hungareze të Drejtësisë për ekstradimin e Nikolla Gruevskit. Kërkesa ka të bëjë me zbatimin e vendimit fuqiplotë të Gjykatës Penale në Shkup, e cila e dënoi me dy vjet burg zotin Gruevski për korrupsion. Po ashtu, ministria maqedonase vë në dukje katër procedurat paralele gjyqësore që po zhvillohen kundër tij nën akuzat për vepra penale. Autoritetet maqedonase nënvizojnë në kërkesë se asnjë prej veprave për çka është dënuar apo akuzohet zoti Gruevski nuk është politike e as veprë penale ushtarake dhe se këto vepra nuk parashihen në konventën evropiane për ekstradim si vepra për të cilat mund të refuzohet ekstradimi. "Të drejtat e Nikolla Gruevskit në çdo kohë janë siguruar, përfshirë të drejtën për mbrojtje para organeve gjyqësore në pajtim me konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore. Nikolla Gruevski është mbrojtur duke qenë i lirë dhe në asnjë procedurë atij nuk i është caktuar masa e paraburgimit. Kishte siguruar më tepër avokatë mbrojtës sipas zgjedhjes së tij, me të cilët kishte komunikim të pandërprerë dhe i shfrytëzonte të gjitha të drejtat që i takojnë në bazë të ligjit për procedurë penale", thuhet në kërkesën për ekstradimin. Ministria maqedonase e Drejtësisë bën të ditur më tej se procedurat gjyqësore kundër Nikolla Gruevskit janë vëzhguar nga OSBE-ja, anëtare e së cilës është edhe Hungaria dhe se në asnjë moment nuk ka pasur reageime nga tashmë i dënuari dhe i akuzuari, apo nga pala mbrojtëse për parregullsi gjatë gjyqit. Ish-kryeministri maqedonas kishte gjashtë truproje të angazhuar nga Ministria e Rendit dhe asnjëherë nuk ka pasur ndonjë njoftim nga ana e tij për kërcënime me jetë ndaj tij apo ndaj familjes së tij. Au-



ARRESTIMI

Ish-shefi i shërbimit sekret DSK, Sasho Mijalkov është arrestuar gjatë mbrëmjes në Shkup. Sipas 1TV, Mijalkov është prangosur në hotelin "Merriot" në Shkup, ku më pas është dërguar menjëherë në burgun hetues të Shutikës. Ai është arrestuar me kërkesë të Prokurorisë Speciale, pas informacioneve për rrezik të arratisjes së tij. Arrestimi i tij vjen pas arrestimit të ish-ministrit të transportit Mile Janakievski dhe ish-sekretarit të VMRO-DPMNE, Kiril Bozhinovski.

inë duke shfrytëzuar hapa dhe metoda jodemokratike duke keqpërdorur sistemin gjyqësor në Maqedoni", shkruan zoti Gruevski, duke theksuar "torturat që pas ardhjes së social-demokratëve në pushtet po i përjetonte ai dhe një numër i madh i bashkëpunëtorëve të tij", teksa thekson se ua ka bërë me dije autoriteteve në Budapest se në Maqedoni nuk ekzistojnë kushte për një proces të drejtë dhe të ndershëm gjyqësor dhe as "nuk ishte në gjendje të mbrohej nga përndjekja dhe kanosjet e shumta të incuara nga qeveria", sipas tij. Autoritetet hungareze nuk kanë pothuajse zyrarisht në lidhje me vendimin për dhënien e azilit politik Nikolla Gruevskit, ndërkaq gazeta e përditshme "Magyar Idok", e njohur për afërsinë me pushtetin, shkruan se janë pranuar të gjitha ankesat, të cilat zoti Gruevski i kishte paraqitur në lidhje me trajtimin në Maqedoni, si gjatë procesit gjyqësor, po ashtu edhe për rrezikun nëse përfundonte në burg. Gazeta shkruan se Gruevski kishte marrë mesazhe kërcënuesë javë e fundit. Ai u arratis nga Maqedonia përmes Shqipërisë, siç kanë pohuar autoritetet policore shqiptare, megjithëse ende ka paqartësi se si ka hyrë brenda territorit shqiptar. Gruevski kishte kaluar nga Shqipëria për në Mal të Zi më datë 11 nëntor tek vendkalimi Hani i Hotit, i shoqëruar nga zyrtarë të ambasadës hungareze, me një makinë me targa hungareze. Nga Mali i Zi ai kishte kaluar në Serbi dhe sipas shtypit serb, kishte kaluar në vendkalimin kufitar Horgosh me Hungarinë në orën 5 të mëngjesit të 12 nëntorit. Autoritetet kufitare serbe i kishin kërkuar, sipas shtypit në Beograd, përveç letërnjoftimit edhe ndonjë dokument tjetër udhëtimi dhe "Gruevski në atë rast kishte treguar një dokument që i mundëson vetëm një hyrje në Hungari të lëshuar nga ambasada hungareze në Tiranë. Pastaj ai është lejuar të kalonte në territorin e Hungarisë". Ish-kryeministri maqedonas, Nikolla Gruevski duhej të vuajë dy vjet burg për shkak të ushtrimit të ndikimit për përfitimim e një dhuratë të jashtëligjshme përmes një tenderi po të jashtëligjshëm, përkatësisht për blerjen e një "Mercedes"-i luksoz prej rreth 600 mijë eurosh nga buxheti i Ministrisë së Rendit.

"Vetëm më 13 nëntor, INTERPOL-i dorëzoi urdhër arrestin"

Vuçiç: S'e ndihmuam Gruevskin, kishte letërnjoftim nga Tirana

Në një intervistë për mediat vendëse, Vuçiç shpjegon se Serbia nuk mund ta ndalonte Gruevskin, pasi ai kishte kaluar në territorin serb drejt Hungarisë, përpara se INTERPOL Shkupi të lëshonte urdhrin e arrestit. "Vetëm më 13 nëntor, në orën 19:35, nga INTERPOL Shkupi na është dorëzuar një urdhër arresti. Por, nëse e ndalnim para lëshimit të urdhër arrestit, do të konsiderohej sikur ne e kishim rrëmbyer Gruevskin. Ne nuk jemi vend i egër". Duke iu referuar dokumenteve, Vuçiç shpjegon se Gruevski hyri në Hungari përmes territorit serb,



duke përdorur dokumente të rregullta, i shoqëruar nga persona me pasaporta diplomatike. "Më 12 nëntor, në 5:11 minuta, personi në fjalë u largua nga Serbia përmes pikës kufitare të Horgoshit me një le-

jekalimi me numër 100.501 të lëshuar në Tiranë, me letërnjoftim të rregullt. Personat që e shoqëronin kishin automjetet dhe pasaporta diplomatike". Leja e kalimit që përmend Vuçiç, ndoshta i është lëshuar Gruevskit nga ambasada e Hungarisë në Tiranë për të hyrë në territorin e saj, pasi autoritetet maqedonase ia kanë sekuestruar atij pasaportën që në korrik të 2017-ës, kur ndaj tij nisën hetimet për disa raste korrupsioni, nga frika e arratisjes.

toritetet maqedonase kërkojnë ekstradimin e Nikolla Gruevskit dhe duke pasur parasysh seriozitetin e veprave penale, këmbëngulin që ai të privohet nga liria dhe të mbahet në paraburgim. Shkupi ka lëshuar fletarrest ndërkomëtar kundër tij. Por, ish-kryeministri maqedonas, Gruevski ka reaguar të martën pasditë në "Facebook", ku shkruan se autoritetet hungareze i ishin përgjigjur pozitivisht kërkesës së tij për strehim politik. Në një status të gjatë, ai shkruan se pushteti i drejtuar nga Lidhja Social Demokratike në Maqedoni po bënte përndjekjen politike të tij. "Qeveria dëshiron të më marrë lir-

DHJETËRA TË VRARË NË NJË SHPËRTHIM NË KABUL

Zyrtarët afganë thonë se së paku 43 veta u vranë dhe 83 të tjerë i plagosën në një shpërthim vetëvrasës, në një mbledhje të studiuësve fetarë në kryeqytetin Kabul. Zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme, Najib Danish tha se vetëvrasësi e shpërtheu jelekun me eksploziv ndërsa njerëzit ishin mbledhur për të shënuar ditëlindjen e Profetit Mohammed.



FOTOLAJM

RRËFIMI

FATOS KONGOLI:

Për Lilin, letërsinë, eutanazinë dhe ata që u detyroj jetën

Fatmira Nikolli

Një orë në panair me shkrimtarin që rrëfen muajt pas sëmundjes

Është mirë për ju te "Friend's Book House"? Të nesërmen, një burrë me xhakete kadife, me kapele beretë, shkelte gjethet e rëna, në rrugicën që ndahet prej 'Myslym Shyrit' dhe e dëgjoja të më rrëfente Shqipërinë e Kinën, duke u ndalur herë pas herë në disa ngjarje disi më gjatë.

Ka kaluar pothuaj një dekadë prej herës së parë, kur kam takuar Fatos Kongolin. "Jetë në kuti shkrepëshesh" çmohej shumë nga lexuesit e megjithatë shkrimtari bëhej bashkëbisedues duke i bërë të padukshme dasitë e moshës, dijës, përvojës. Nuk kisha mbërritur ende, moshën e romanit të tij të parë, por me kujdesin fisnik të një burri të urtë, ai i zhbënte kufijtë, duke plotësuar heshtjet e mia a pyetjet që nuk guxoja t'i shqiptoja deri në fund. Nga "Në të tre", te "I Humburi", nga "Lëkura e qenit" te "Dragoi i fildishtë" e "Ëndrra e Damokleut", ai kish vënë emrin e tij si shkrimtar, por duke ruajtur njëherësh edhe njëfarë distancë nga radha e parë. E pranonte se kishte qenë gjithnjë disi i ndrojtur.

Në vitin 2011, kur promovonte "Iluzione në sirtar" pothuajse një roman për vetveten, ai do të bënte një 'mea culpa', duke kërkuar falje publike për një episod traumatic të jetës së tij, kur iu desh të dilte dëshmitar në gjyqin e një kolegu. Kur botuesja i kishte thënë se ishte koha për letërsi, e jo për kujtime dhe se do të kishte kohë për kujtime, Kongoli i ishte përgjigjur se kishte nevojë të thoshte, duhej ta thoshte, nuk mund ta mbante më brenda tij.

"Kam dashur të bëj një rrëfim, për aq kohë sa bashkëkohësit e mi të përmendur në këtë libër janë gjallë. Nuk kam dashur t'i shpëtoj gjykimit të njerëzve. Pjesa dërmuese e personazheve janë gjallë. Dhe një nga arsytet pse kam dashur ta shkruaj librin është pikërisht për këtë fakt. Më vonë, kur ca prej tyre të mos jenë më, ndoshta do të ishte shumë vonë, sepse nuk do të kishte kush të më gjykonte". Atëkohë, teksa rrëfeu kokulur e me pendesë ç'kish ndodhur, doli para lexuesit, për të treguar vetë një kohë të vështirë për të cilën nuk ishte krenar. E cilësuan rast unik. Kongoli që kishte bërë gati kraharonin për sulme, mori rrahje shpatullash si vlerësim.

Pasi e hoqi brengën e pengun e madh, mërinë e madhe, dhimbjen e madhe, ndjenjën e madhe të fajit, me paqen që fitoi, ju kushtua letër-



Shkrimtari Fatos Kongoli

"I detyrohem mikut tim të vjetër Julien Roche, që më mori e më strehoi në shtëpinë e tij madhështore në Qerret. Më strehoi pesë muaj. Më vuri në dispozicion edhe fizioterapist dhe gjithë personelin që i shërben atij. Atij njeriu i detyroj jetën. Nëse vendos të shkruash, mos e harro këtë", më thotë. Kur pohoj, ai shton: "Dhe sigurisht i detyrohem edhe Lilit, gruas sime. Ajo është përpjekur me mish e me shpirt që unë të shërohesha"



sisë, derisa muaj më parë, u sëmur rëndë. Në bisedat telefonike të atyre ditëve, mes një dhome spitali dhe një zyre redaksie, kur herë më përgjigje ai e herë e shoqja Lili, zë fill, edhe kjo bisedë. Për shkrimtarin dhe njeriun Fatos Kongoli.

PANAIR 2018

Është e premtë dhe Kongoli është ulur në stendën e "Toenës". Lexues të ndryshëm, ndalojnë, e shohin, shohin librat e tij, zgjedhin një dhe i kërkojnë autograf. Kongoli ngrihet nga karrigia në këmbë, flet me ta, u lë herë një shënim e herë një firmë dhe ulet. E pyes, ku është bashkëshortja. Më përgjigjet që është në shtëpi.

"Jam shumë më mirë se ç'kam qenë. Pas ndërhyrjes erdhi djali e qëndroi disa kohë". E pyes nëse po shkruan, mohon. Flet me lexuesit, dhe një cast më pas, pëshpërit me mirënjohje. "Ke bërë shkrime të mira për mua". Pastaj kujton bisedat ndërsa ishte në spital. Në fillim përgjigje Lili, zonja e tij, pastaj vetë ai. Kërkonte ndjesë. Atëkohë, ishte në një gjendje pezulli mes operacionit të parë dhe atij të dytit, në kohën e ndërmetjetme, atë të pritjes; kur nuk e di sa zgjat kjo pritje, çfarë ka pas saj, as nëse do kthehesh nga ajo udhë.

"Kam qenë gjysmë atëherë. Shkova shumë afër... Shkova, trokita... Por më thanë jo, nuk ka ardhur casti".

Botuesja Irena Toçi më kish rrëfyer se njeriu që e ka mbajtur Kongolin gjatë gjithë jetës, por edhe ato ditë kur ai e rrezikonte atë, ka qenë e shoqja, Lili. Një grua e heshur, që nuk shihet, nuk del, nuk njihet, por që është aty për të shtrirë dorën a për ta tërhequr atë.

Ia them Kongolit këtë. Ai qesh. Pohon që ajo ka qenë e rëndësishme në atë që vetë ai është sot. "I detyrohem shumë. I detyrohem shumë se është sakrifikuar gjithë jetën për mua. Më ka krijuar gjithë kushtet që unë të punoja dhe...". Hesht një hop. Diku e tret shikimin. Diçka sjell ndërmend dhe më tej thotë: "Kam qenë njeri i vështirë. Gjithë shkrimtarët janë të vështirë. Se janë njerëz egoistë, shumë. E unë, kam qenë jashtëzakonisht i vështirë".

E pyes nëse dikur, e ka bërë të lumtur aq sa ajo të qëndrojë ashtu e përkushtuar përkrah tij gjithë jetës? Kongoli nuk duket fort i kënaqur me veten. "Është natyra e saj e tillë. Sidomos këtë rast që u sëmura. Isha keq. U bëra dy herë operacion. Ajo ka vuajtur shumë. I detyrohem shumë. Ka bërë çdo gjë".

Vijnë lexues të tjerë. Shquaj mes tyre një shkrimtar të ri, Azem Delliun. I pëshpërit Kongolit se ai që ka përballë e kërkon autograf, është



Shkrimtari Fatos Kongoli

të shkrimtar i ri. Ai mbi faqen e parë shënon "Për kolegun tim të ri". Dëliu zgëzohet dhe Kongoli i uron përzemërsisht suksese.

Rikthehet te biseda jonë dhe ndalet për të kujtuar ata që i qëndruan pranë, shumë pranë, ata që e mbajtën në jetë.

"I detyrohem mikut tim të vjetër Julien Roche, që më mori e më strehoi në shtëpinë e tij madhështore në Qerret. Më strehoi pesë muaj. Më vuri në dispozicion edhe fizioterapist dhe gjithë personelin që i shërben atij. Atij njeriu i detyroj jetën. Nëse vendos të shkruash, mos e harro këtë", më thotë. Kur pohoj, ai shton: "Dhe sigurisht i detyrohem edhe Lilit, gruas sime. Ajo është përpjekur me mish e me shpirt që unë të shërohesha". I them se ka bërë diçka më të rëndësishme, nuk të ka lënë kurrë vetëm.

"Absolutisht edhe kjo. Por gjatë sëmundjes, ka qenë një moment shumë i vështirë. Po të mund t'ju thosha, çfarë ka bërë ajo për mua...nuk e imagjinoja as vetë. Isha shumë shumë keq". Thekson se kishte besim të plotë të mjekët, te doktor Pojani dhe kirurgu Edmond Çeliku.

E pyes nëse ishte Lili ajo që e mbajti në jetë pothuaj me zor. "Ajo ka një rol e një meritë shumë të madhe që më mbajti në jetë. Megjithatë, mendoj shpesh se duhet të ketë një providencë. Ai ta jep, ai ta merr". Thotë se ka kohë që beson në Zot, por se marrëdhënia me të, është krejt individuale dhe nuk kalon as nga kleri as nga institucionet e besimit.

Kërkoj portretin e Lilit në librat e tij, dhe e pyes çfarë i ka kushtuar gjithë këtë vete. "Një roman", thotë me nxitim dhe e merr në dorë. "Është romani 'Lëkura e qenit'. Ia kam kushtuar asaj. Në fakt Lëkura e qenit jam unë. Ajo e ka lexuar vetëm pasi është botuar".

MENDIMET NË SPITAL

Ato kohë, kur luftonte për jetën, thellë brenda vetes, kishte marrë parasysh se ky, mund të ishte edhe fundi. Nuk kishte pengje,



“

"E mendova, e përfytyrova kështu. Sikur do hipja në një taksì. Nuk e di ku do më çojë. Nuk mund ta di. Nëse më çon në një rrugë pa kthim, atëherë punë e madhe: unë atë dua. Nëse do të kthehem mbrapsht, do jem aty ky isha". Kërkoj të di, nëse Lili, ishte dakord me këto mendime? Me eutanazinë përshembull. "Ç'mund të bënte apo të thoshte Lili? Ajo e shihet gjendjen time", thotë Kongoli.

as brenga. Gjithsesi e dinte që mund të kishte shkruar më shumë, që mund të kishte shkruar edhe për disa tema të tjera, por ishte i qetë se brengat e mëdha e historitë e mëdha i kish rrëfyer.

"Kur e mora vesh sëmundjen që kisha, kur mora vesh se si do të isha, më shkoi mendja deri te eutanazia. Mendova, ç'më duhet mua jeta në atë gjendje që do isha?"

Që kur hyra në operacion, unë hyra pa frikë. Më kanë pyetur shpesh miqtë e mi, nëse kisha

frikë. Por nuk kisha frikë hiç fare, as te operacioni i parë, as te i dyti. Të dyja herët kam hyrë në sallë duke qeshur". Kongoli qesh kur rrëfen. Herë-herë shpjegon me duar, herë-herë kthen kokën nga librat e tij, që kryesisht mosha të reja, i marrin në duar për t'i shfle-tuar.

E pyes, pse ishte kaq i qetë, si ia dilte. "E mendova, e përfytyrova kështu. Sikur do hipja në një taksì. Nuk e di ku do më çojë. Nuk mund ta di. Nëse më çon në një rrugë pa kthim, atëherë punë e madhe: unë atë dua. Nëse do të kthehem mbrapsht, do jem aty ky isha". Kërkoj të di, nëse Lili, ishte dakord me këto mendime? Me eutanazinë përshembull. "Ç'mund të bënte apo të thoshte Lili? Ajo e shihet gjendjen time", thotë Kongoli.

E ka rrëfyer bashkëshorten hollësisht tek "Iluzionet në sirtar" si dhe i ka kushtuar "Lëkurën e qenit". Flet pak për të, ka drojë kur e bën, por ndjen në timbrin që merr zë, respektin për gruan që e jetoi me të e për të.

74-vjeç e ish-matematicien, Kongoli ndjen keqardhje që leximi ka rënë. Dikur, në rininë e tij, ishte kënaqësi e madhe.

"Nuk mund të ketë më tërheqje si dikur, sepse dikur s'kishte asgjë tjetër për të bërë. Leximi ka rënë kudo, edhe në botë. Nuk është dukuri shqiptare, por këtu është disi më e vrazhdë, si çdo gjë. Të lexuarit është punë fisnike, por është krijuar perceptimi se leximi nuk jep asgjë. Dikur, ishte kënaqësi leximi. Unë vetë kam kohë që nuk e shijoj leximin: sepse si shkrimtar, shoh stilin, ndërtimin, shoh strukturën. Më vjen keq, sepse sa marrë në dorë libër, i shoh teknikën. Kam harruar ç'është leximi vetëm për kënaqësi, me endje, me dëshirë".

Pohon se tanimë u është rikthyer ritualeve, ecjeve të lehta, shëtitje deri nga liqeni dhe një kafe herët me Lilin në Friend Books House. Shkrimtari është në qytet, me beretë mbi kokë e me një xhakë të kadife, hapat e tij kërcasin mbi gjethet e rëna këtij mesnëntori.

KRIKUA

Këndvështrim tjetër për letërsinë e traditës

Nga prof. dr. Alfred Çapaliku

Një monografi prej mbi 300 faqe, publikuar këtu ditë si libër nga shtëpia botuese "Naimi", dr. Ermira Alija, pedagoge e Universitetit "Luigj Gurakuqi" i Shkodrës, jep kontributin e saj mbi fenomenin intrigues "Letërsia shqipe si metafizikë dhe transhëndencë". Përmes shtatë krerëve dhe të një eseje në vend të konkluzioneve, Ermira analizon qasjen filozofike të studiuësve dhe mendimin e kritikëve të specializuar për këtë problem kompleks, si dhe praktikimin letrar të qëllimorës e të metafizikes nga Humanizmi gjer në Romantizmin e letërsisë sonë. Aty paraqiten qëndrimet dhe opinionet e krijuara mbi këto dukuri paralele, së bashku me trajtimet vetjake mbi këto dy çështje sa të kapshme, aq edhe ikëse.

Në kreun e parë me titull "Konteksti filozofik e social i ndryshimit të qasjes ndaj letërsisë e lindja e diskutimit mbi letërsinë qëllimore", mbështetur në thënien e E. Kantit mbi çlirimin e të bukurës nga interesi, si dhe në mendimet e Winclemann-it, Avenenës, Jubanit, Gurakuqit, Çabejt, Poradecit, Rugovës, Kadaresë etj., termin "Letërsi qëllimore" studiuësja e shikon herë si konvencë të përdorimit e herë si relacion të brendshëm me një objekt të përcaktuar. Kjo marrëdhënie e autorit me artin e vet dhe nëpërmjet tij me lexuesin është ilustruar me poetin Gavril Dara (i Rriut), i cili këtë lexues nuk e pa kurrë me sy, meqë poema iu botua pas vdekjes. Nëse estetist rumun Adrian Marino flet për letërsi funksionale, shkrimtari Ernest Koliqi e dallon qëllimin e saj nga abuzimi me të, eruditit Krist Maloki mungesën e lëvizjes artistike individuale e klasifikon "politike", kulturologu Mitrush Kuteli tregon karakterin e vetëmjaftueshëm të letërsisë, kritikuri Arshi Pipa jep postulatit "majat poetike qëndrojnë mbi retë ideologjike", ndërsa studiuësja Sabri Hamiti paraqet sentencën "Letërsia është shkrim që kërkon lirinë e vetvetes si dëshmi personale".

Si pedagoge Ermira Alija ndien elementet didaktike në letërsinë shqipe të shekujve XVI-XX, ndërsa si kërkuese dallon bazamentet estetike të letërsisë gjatë këtij harku kohor, kur lindën edhe krijime që i mbetën besnike motivit qëllimor, por edhe vepra që e tejkaluan atë. Në kreun e dytë, titulluar "Metodologjia dhe baza teorike referuese, interpretime", letërsinë qëllimore autorja e sheh jo si emërtim klasifikues, por funksional. Mbështetur në teorinë e Beardley dhe Wimsatt se "inten-



Studimi i pedagoges nga Universiteti i Shkodrës, dr. Ermira Alija

Në kreun që mban për titull: "Çështje të letërsisë, misticizmit, kozmogonisë, notave sociale", autorja qëndrohet në krijimtarinë përfaqësuese të Nezim Frakullës dhe raportin e saj me shqipen, duke e krahasuar atë me prurjet e autorëve të tjerë të letërsisë me shkrim oriental, ku vë në dukje letërsinë si reflektim

cioni i autorit është tharimi i një pjese të letërsisë, por s'mund të jetë një standard mbi të cilin mund të kuptohet dhe të gjykohej puna", ajo e pozicionon veten qartë rreth këtij problemi të sofistikuar: "duke i pënuar letërsisë si vlerë të parë estetiken nuk do të thotë se i mohojmë vlerën e tjera... Qëllimsh-mëria, kur është e pleksur brenda strukturës së veprës, mund të mos jetë e vështirë të vërehet, por është e vështirë të përshkruhet e të përkufizohet". Kështu, në kreun "Elemente letërsie dhe vërtetësie te "Historia e Skënderbeut" e Marin Barletit, studiuësja merr në shqyrtim veprën e njohur historiko - letrare të shkruar në latinisht dhe të menduar në gjuhën shqipe. Në prizmin e letërsisë qëllimore, ajo zbulon autonominë semantike që mban brenda vetes ky libër "Dolce et utile" e, njëkohësisht, metafizikën e lirisë dhe të adheut.

Në kreun e katërt, "Elemente letërsie në shkrimin bibliotekë", gjatë ekskursionit qëllimor në letërsinë filobiblike nga Buzuku gjer te poezia e kushtimit, dr. Ermira Alija zbulon vlerat e gjuhës shqipe, ku brenda guackës formohet perla. Për të arritur gjer këtu ajo i referohet konstatimeve të vyera dhe elegante të Fatbardha Hoxhës se "Barleti dhe Buzuku e njihnin thellë etninë e tyre", dhe të Shaban Sinanit se "Përkthyesit e ungjijve nuk deshën t'ia dinin që do të konkurronin në gjuhën e Virgjilil e të Horacit... kjo ishte shprehje e një besimi të fuqishëm në verbin amtar". Nga ana e saj, Alija thotë: "Letërsia del në pah kur tejkalohej misioni. Budi, Bogdani dhe autorët e tjerë të Qarkut të Veriut patën një qëllim më specifik; t'i jepnin librit vlerën e institucionit shpirtëror të shkruar". Rindërtimi i përkthimit përmes tregimit të lirë të ngjarjeve dhe përkthimit të personazheve apo krijimi i vargjeve personale si shprehje e originalitetit e kthen letërsinë qëllimore në qëllim përkthimor.

vetjak gjuhësor. Kurse, në kreun VII, titulluar "Romantizmi si çështje letërsie", Ermira Alija u referohet Rexhep Qosjes dhe Robert Elsie. I pari përgjithëson: "Letërsia e Rilindjes lindi kur në jetën historike të kombit nuk ishin diferencuar plotësisht as sferat e jetës kulturore, as institucionet politike, shoqërore...". I dyti veçon: "Para se të bëhej entitet politik, Shqipëria ishte bërë realitet politik në veprat e Jeronim de Radës". Nga ana e saj studiuësja procedon se në fillim të shekullit XX letërsinë nuk e bëjnë më rrymat letrare, por personalitetet letrare, duke qmizuar apo anashkaluar ato tema që vetëm pak më parë i kishin shërbyer saj; mbasi letërsia shkëputet dalëngadalë nga funksioni intencional. Kjo dukuri shënon fillimin e letërsisë moderne shqiptare. Më tej autorja sintetizon: "Në letërsi lind një artistike që është e vështirë të ndahet nga qëllimorja, por edhe që është e vështirë të identifikohet me të". Tek nëntemat e këtij kapitulli: "Naim Frashëri, poeti më kompleks i ideologemës" dhe tek "Transhëndentalizmi i Naimit, formë e modernitetit të poezisë", studiuësja hedh idenë se "Naimi jeton gjatë, sepse ai nuk i përket asnjë lloj ideologjie të caktuar, përveç ideologjisë që krijon poetizmi i tij". Këtë pikëpamje ajo e rimerr më pas duke konkluduar: "Nuk besojmë se ka përgjigje absolute nëse Naimi është më shumë poet apo profet". Përgjigjia e pyetjes është e lidhur me funksionin e letërsisë, problem që shtrihet në mbarë studimin e autorës, si çështje që ka qenë gjithnjë relative dhe me gjasë vazhdimisht do të jetë e tillë.

Tema e trajtuar nga dr. Ermira Alija është e vështirë dhe jo fort e rrallur, por, me botimin e veprës "Letërsia shqipe si metafizikë dhe transhëndencë" studimet tona filologjike tashmë pasurohen me një kontribut me vlerë për këtë argument.

Opinion i Ditës

Përse Brexit s'po gjen dot daljen?

Nga Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... e madhe e sherrit në politikën britanike; dy vjet pas fitores së ngushtë të Brexit, ajo ka vënë seriozisht në dyshim mbijetesën e qeverisë, të kryeministres Theresa May dhe vetë procesin e daljes (exit) nga BE-ja.

Për ta bërë sa më të kuptueshme analizën tonë, kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të katër blloqeve problematike që evidentohen në 585 faqet e kësaj marrëveshjeje, të cilat nuk mund të "përtypen" e le më të "gëlltiten" nga breksitasit (leavers) që duan një orë e më parë dhe me kosto minimale largimin nga BE-ja.

Blloku i parë ka të bëjë me periudhën kalimtare nga 19 marsi 2019, kur fillon divorci zyrtar me BE-në deri në fund të vitit 2020. Në këtë hapësirë kohore synohet të hartohet dhe nënshkruhet Marrëveshja Tregtare dypalëshe, e domosdoshme sidomos për Londrën. Mirëpo, përvoja tregon se nënshkrimi i saj brenda kësaj periudhe është i pamundur. Kështu, p.sh., për Traktatin e ngjashëm BE-Kanada u deshën plot shtatë vjet! Për pasojë, periudha kalimtare do të shtyhet për afate të pacaktuara, duke irrituar shumë breksitasit.

Blloku i dytë problematik për breksitasit është se praktikisht Bashkimi Doganor me BE-në do të vazhdojë të funksionojë deri në përfundim të periudhës kalimtare të lartpërmendur. Për pasojë, nuk do të ketë kontrolle doganore në Dover dhe Calais, kufiri me Irlandën e Veriut do të qëndrojë i hapur, etj.

Blloku i tretë dhe më shqetësues për ta është se Britania e Madhe do të vijojë të zbatojë rregullat dhe ligjet e BE-së deri sa të dalë përfundimisht prej saj, që siç u përmend më lart, mund të vijojë me vite të tëra. Kjo do të thotë që vendet anëtare të BE-së do të vijojnë si deri tani të mbështesin dhe nxitin me ndihma dhe subvencione eksportet, kompanitë e tyre të biznesit, produktet bujqësore, etj. në gjithë Evropën, sikur Brexit të mos ekzistonte fare.

Për më tepër, Londra do të vijojë të shlyejë detyrimet financiare ndaj BE-së që shkojnë në mbi 50 miliardë euro në vit.

Blloku i katërt dhe i fundit pengues është krijimi i një Komiteti të Përbashkët me ekspertët nga të dyja palët, i cili do mbikqyrë dhe vendosë për ecurinë e mëtejshme të proceseve/procedurave të lartpërmendura të daljes nga BE-ja. Ky Komitet do të vendosë për zgjatjen e periudhës kalimtare dhe nëse janë krijuar kushtet për daljen prej BE-së.

Kjo i ka shqetësuar së tepërmi breksitasit të cilët donin që ky komitet të përbejë vetëm nga britanikët. Ndaj, sipas tyre, Britania e Madhe dhe pas Brexit do



të jetë "quasi" pra pothuajse anëtare e BE-së, duke zbatuar dispozitat e saj ligjore edhe pse pa të drejtë vote! Shkurt, për ta Londra do të vazhdojë kush e di për sa kohë të jetë vasale dhe nën "hyqmin" e Brukselit!

Janë pikërisht këto fakte dhe faktorë që gjatë ditëve të fundit kanë tensionuar në kulm marrëdhëniet e kryeministres Theresa May me Kabientin qeveritar dhe sidomos me Parlamentin britanik, opozitën, etj. Disa ditë më parë, Ministria e Punës dhe Sekretari i Shtetit për Brexit, Dominic Raab dhanë dorëheqjen në shenjë proteste. Megjithatë, fronti i vërtetë i betejës mbetet Dhoma e Ulët ku ky projekt do të votohet në muajin dhjetor.

Në këto kushte, politika,

qeveria dhe sidomos kryeministria May po ballafaqohen me një gjendje tejet kritike dhe me pesë skenarë të zymtë, njeri më dramatik se tjetri. Siç mund të shihet më poshtë, këta skenarë me plot të panjohura mund ta vësh-tirësojnë, vonojnë e ndoshta ta bëjnë të pamundur "exit" pra daljen e Britanisë së Madhe nga BE-ja.

Dorëheqja e kryeministres May dhe zëvendësimi i saj me një nga mbështetësit e "betuar" të Brexit, si ish-ministri i jashtëm Boris Johnson, apo ish-sekretari i Shtetit për Brexit Dominic Raab, etj do të shtronte nevojën e bisedimeve të reja me BE-në që vetëm se do të zgjatnin dhe me shumë procesin me të papritura të tjera, ndoshta dhe më problematike;

ndaj dhe May në prononcimet e saj zyrtare dhe publike nuk pranon të japë dorëheqjen, duke e mbrojtur me pathos projektin e saj, si alternativën më të mirë për të dalë nga BE-ja; gjithë të tjerat sipas saj nuk të çojnë askund.

Po aq problematik është dhe votëbesimi i kryeministres May në parlamentin britanik. Ajo kryeson një qeveri pakice dhe mbahet vetëm me votat e nacionalistëve të DUP të Irlandës së Veriut që janë të pakënaqur me këtë projekt. Por dhe vetë brenda konservatorëve britanikë ka shumë kundërshtarë të këtij projekti, duke e bërë shumë të mundshëm mosbesimin ndaj Kryeministres May. I vetmi hezitim në këtë mes është frika nga zgjedhjet e reja, ku mund të fitojnë laburistët që, gjithashtu, e kundërshtojnë këtë projekt.

Skenari tjetër drithëruar për konservatorët janë zgjedhjet e parakohshme, të cilat mund të fitohen nga laburistët pas shumë viteve në opozitë. Por dhe ajo nuk është shumë e interesuar për këto zgjedhje, pasi ka shumë kundërshtime të brendshme ndaj liderit 70 vjeçar majtist Jeremy Corbyn. Veç kësaj, dhe laburistët nuk kanë ndonjë alternativë më të mirë se kjo e sotmja.

Skenari i katërt i daljes nga ky qerthull mbetet rishikimi me ndryshimet përkatëse në bashkëpunim me BE-në në të katër blloqet e lartpërmendura; mirëpo kjo e fundit, siç u pa dhe në takimin e ministrave të saj të financave këtë javë në Bruksel, me përjashtim të ndonjë lëshimi kozmetik apo kortezie nuk ka ndërmend të lëshojë "pe" as në Samitin e posaçëm të 25 nëntorit për Projekt Marrëveshjen e "divorcit" me Britaninë e Madhe; ky fakt e ndërlikon më shumë këtë situatë dhe alternativë.

Skenari i fundit i mundshëm është përsëritja e referendumit për Brexit. Kërkesat për këtë janë shtuar, ka një peticion me mbi një milion firmëtarë, duke përfshirë ish-kryeministrin emblematik Tony Blair.

Por, përsëritja e këtij referendumi brenda dy apo tri vitesh pas të parit do të krijonte një precedent të keq demokratik në të ardhmen dhe do të krijonte turbullira politike masive nga ana e mbështetësve të Brexit. Rreziku dhe pikëpyetja tjetër e madhe është se çdo të ndodhë nëse dhe në referendumin e dytë fiton sërish "Brexit" si do të vijohet më tej?

Nga këto zhvillime post Brexit dalin katër përfundime dhe mësimë madhore që i kalojnë kufijtë e Britanisë së Madhe dhe të BE-së. E para, kujdesi lidhur me referendume për është të tilla të ndërlikuara ku kërkohet thjesht një "Po/ Jo" ose "të qëndrojmë apo të dalim nga BE-ja" (leave or remain) Së dyti, këto referendume duhet të paraprihen dhe shoqërohen me një diskutim dhe publik, me analiza tërësore mbi kostot dhe përfitimet shumë-planëshe. Ndryshe do të ndodhë si me shprehjen tonë: "hidh një lek të hysh në valle, fut 100 por s'del dot fare" Së treti, me gjithë kritikën dhe mangësitë e njohura për të cilat BE-ja është e vetëdijshme dhe ndodhet në procesin e reformimit të saj tërësor, siç po nënvizohet në medianë e huaj, "është më mirë të qëndrosh brenda BE-së, sepse jashtë saj është shumë më ftohët"

Për pasojë, dhe ndonjë vend tjetër që mund t'i shkojë ndër mend të dalë nga BE-ja, tani e tutje do t'i duhet të mendohet mirë. Në kushtet e sotme të globalizmit, asnjë shtet kombëtar dhe nacionalist, sado i madh dhe i fuqishëm, nuk mund të trajtojë dhe ca më pak të zgjidhë pa bashkëpunim shumëpalësh sfida dhe fenomene të tilla planetare, si ngrohja globale, mbrojtja e mjedisit, krimi i organizuar, kriza e azilit, terrorizmi ndërkombëtar, mashtrimi financiar, etj.

Së fundi, dhe jo më pak e rëndësishme, fakti që Brexit, fitorja e tyre e parë nuk po gjen dot dyert e daljes nga Brukseli është ogur i keq për forcat populiste, ekstremiste dhe euroskeptike, dëshitimi i të cilave me siguri është thjesht çështje kohe.

Por, përsëritja e këtij referendumi brenda dy apo tri vitesh pas të parit do të krijonte një precedent të keq demokratik në të ardhmen dhe do të krijonte turbullira politike masive nga ana e mbështetësve të Brexit. Rreziku dhe pikëpyetja tjetër e madhe është se çdo të ndodhë nëse dhe në referendumin e dytë fiton sërish "Brexit" si do të vijohet më tej?

Opinioni *i* Ditës

Salillari, Ramallari dhe ne të tjerët

NGA ANDI BUSHATI*

(vijon nga faqja 1)

... Ajo shtoi, aty për aty, se kjo firmë ndërtimi rrugësh "po i merr të gjitha, që mos u ngoptë inshalla".

Pavarësisht se Salillari mund të ketë qenë njësoj i pangopur edhe në kohë të PD edhe në kohë të LSI-së, e shkëputur nga sfondi kohor, ideja se ai po i rrëmben të gjitha duket e drejtë.

Tani, me dokumente ne kemi të vërtetuar se tenderi 40 milionë eurosh i Unazës së Re është zhvilluar me një garë fiktive, ku një ndërtesë i vetëm, "Vëllezërit Hysa", ka marrë pjesë në konkurrimin e tre loteve të kësaj rruge, gjithsej 2.2 kilometra, duke zhdukur çdo lloj ndershmërie.

Natyrisht, këtu gjithkush mund të dyshojë se kemi të bëjmë me një aferë të pastër korruptive. Gjithkush mund të hamendësojë, po ashtu, se sa miliona euro mund të ishin kursyer nga një tender i drejtë dhe se si ato mund t'i kishin kompensuar të gjithë banorët që sot po flaken në rrugë.

Pra, siç shikohet, deri këtu ironia është therëse.

Nga njëra anë kemi Rilindjen, që tregohet dorëlëshuar me klientët e saj, të cilët fryjnë faturat e tenderëve fiktivë, e që bëhet cingune për dëmshpërblimet e qytetarëve të mjerë që do t'u shembë shtëpitë.

Në anën tjetër kemi LSI-në (pa përfshijtur këtu edhe demokratët) që u bën thirrje ish-klientëve të saj, që tani po punojnë me Ramën: "Boll, se nuk u ngopët!".

Por, kulmi i kulmeve të kësaj balloje me maska gjendet diku tjetër. Atë e zbulova papritur duke lundruar në internet, për të qëmtuar lidhjet e kompanisë Salillari me pushtetet e ndryshme politike. Dhe imagjinoni ç'më doli para syve. Një video e botuar nga ERTV, ku Edi Rama shfaqej në rolin e bamirësit. Ai kishte qenë disa muaj më parë në Marikaj të Vorës, ku si kryeministër i një vendi të begatë, paskësh zbuluar një familje në skamje.

Natyrisht, kryeministrit që i digjet shpirti për të varfrit (ky që një nga sloganet e ardhjes së tij në pushtet në 2013) nuk mund ta duronte këtë. Prandaj ai ndërmonte një nismë. T'i ndërtonte shtëpinë asaj familjeje dhe të punësonte kryetarin e saj.

Këto premtime, të bëra realitet, duken edhe në videon e transmetuar në ERTV. Shtëpia po ndërtohet dhe i zoti i saj tashmë ka veshur jelekin e punës në një firmë ndërtimi.

Por, po t'i shikosh pamjet me kujdes, vëren një tallje shembullore. Ai burrë i ngratë është



punësuar tek Salillari dhe shtëpinë e tij po e ringre nga e para po kjo firmë. Pra, e njëjta që nga Monika akuzohet se po rrëmben gjithçka, nga Edi reklamohet si bamirëse.

Me një llogari të thjeshtë, del se shtëpia e Marikajt po ndërtohet me një thërmijë nga milionat që "tepruan" nga tenderi

zemërgjerë i Unazës së Re, i cili po hedh në rrugë të madhe së paku 317 familje.

Dhe këtu sarkazma mbërrin kulmin.

Sepse, loja politike me kundërshtarët që akuzojnë njëri-tjetrin se po vjedhin me të njëjtën klientë, në këtë moment cek fundin.

Por, kulmi i kulmeve të kësaj balloje me maska gjendet diku tjetër. Atë e zbulova papritur duke lundruar në internet, për të qëmtuar lidhjet e kompanisë Salillari me pushtetet e ndryshme politike. Dhe imagjinoni ç'më doli para syve. Një video e botuar nga ERTV, ku Edi Rama shfaqej në rolin e bamirësit. Ai kishte qenë disa muaj më parë në Marikaj të Vorës, ku si kryeministër i një vendi të begatë, paskësh zbuluar një familje në skamje.

Pas saj, po hymë në një fazë të re, ku këta oligarkë që kanë bërë namin edhe majtas edhe djathtas, shiten si vlera. Motoja e kësaj fabule është e thjeshtë: ne ju fusim thikën deri në palcë, por ama nuk ju lëmë të vdisin për bukën e gojës. Ne jemi ata që zhysim në xhepa paratë e qindra familjeve që u prishen shtëpitë, por publiku duhet të na njohë si bamirës të të varfërve.

Pikërisht kjo është faza terminale e një procesi të kahershëm degjenerimi. Ndërsa për vite me radhë "salillarët" e kanë bërë emrin e tyre të rimojë me të gjithë liderët, që i kanë lënë vendin njëri-tjetrit, tani, në kohën e dyshes Salillari-Ramallari, po kërkohet që kësaj lidhjeje t'i jepet edhe një tis fisnikërie. Jemi në pikën kur grabitësit po tentojnë të hiqen edhe si bamirës, duke i trajtuar tre milionë shqiptarët e tjerë si idiotët.

***Lapsi.al. Titulli i originalit: Salillari, Ramallari dhe tre milionë rrota ...ari**

HOROSKOPI

DASHI

Do të ndiheni mjaft mirë nga ana shëndetësore. Gjithashtu, do të ndiheni edhe mjaft mirë emocionalisht, çfarë do t'ju rrisë besimin në vetvete. Përmirësimi i financave do t'ju bindë që të bëni disa blerje të rëndësishme. Ka gjasa të përjetoni një tjetër lloj romance.

DEMI

Do t'ju krijohen burime të reja të të ardhurave. Do të takoheni me një mik të vjetër, i cili do t'ju ndriçojë mbrëmjen. Do të kujtoni fëmijërinë dhe ditët e arta. Punoni qetësisht për të arritur qëllimet tuaja.

BINJAKET

Mund të përfshihen në një event bamirësie, i cili do t'ju sjellë paqe në mendje. Motra/vëllai do të tregohet shumë mbështetës ndaj jush, madje më shumë seç mund ta kishit menduar. Ka gjasa të niseni një lidhje të romantike.

GAFORJA

Disa rrethana të pashmangshme mund t'ju përballin me disa probleme. Megjithatë ruani qetësinë dhe mos reagoni menjëherë. Luftoni për t'u shndërruar në model për të tjerët. Ka gjasa që të merrtëni me partnerin/partneren tuaj.

LUANI

Do të shijoni një ditë të qetë me familjen tuaj. Nëse disa persona iu afrohen duke iu bërë të ndiheni keq, zgjidhja më e mirë është t'i shmangni ata. Përpuni ta kuptoni partnerin/partnerin tuaj dhe ta mbështesni atë.

VIRGJERESHA

Përpuni të kontrolloni natyrën tuaj impulsive dhe kokëfortësinë pasi mund të shkaktoni situata të pakëndshme. Financat do t'ju përmirësohen më vonë gjatë ditës. Mbrëmja me miqtë do të jetë shumë argëtuese.

PESHORJA

Përpjekjet e tua të mëdha dhe mbështetja e familjarëve do t'ju sjellin rezultatet e dëshiruara. Punoni edhe më fort për të vazhduar në të njëjtën rrugë. Mos shpenzoni shumë për argëtim apo për look-un tuaj.

AKREPI

Sensi juaj i humorit do të ndihmojë dikë pranë jush të ndihet më mirë. Gërmoni më shumë për të zbuluar disa skema të mira financiare. Shëndeti i partnerit/partneres suaj mund t'ju shqetësojë.

SHIGJETARI

Bëni kujdes me dietën ushqimore. Do të keni dëshirë të realizoni një plan, të cilin keni kohë që e mendoni. Përfitoni nga koha e lirë për të ndënuar më shumë pranë familjes. Sot do të vlerësoheni shumë në punë.

BRICJAPI

Nuk do të ndiheni energjik si zakonisht. Është e nevojshme të qetësoheni sot dhe ta realizoni agjendën tuaj një ditë më vonë. Tregohuni i sinqertë me njëri-tjetër tuaj të besuar dhe pranoni këshillat e tyre.

UJORI

Dicka e jashtëzakonshme mund të ndodhë sot në jetën tuaj. Dashuria për partnerin/partnerin tuaj do të jetë në rritje. Ka ardhur koha e duhur që ta shtrini profesionin tuaj edhe në vende të tjera.

PESHQIT

Personat e kësaj shenje që vuajnë nga zemra duhet pajtë të heqin dorë nga kafja. Kushtojni më shumë kohë fëmijëve tuaj. Sot do të kuptoni se partneri/partnerja ju do pafundësisht.

ARRITJE HISTORIKE



Kosova arriti që të fitonte me rezultatin 4 me 0 përballë Azerbajxhanit, duke marrë kështu një fitore historike në Ligën e Kombeve. "Dardanët" kanë arritur që të renditen të parët në grup, duke u ngjitur kështu në Ligën C dhe në vitin e ardhshëm nuk përjashtohet dhe një përballje me

Kosova shkatërron Azerbajxhanin dhe kualifikohet në Ligën C

Shqipërinë. Pjesa e parë mbyllet me këtë rezultat, ndërsa në të dytën "dardanët" shënuan edhe tri herë të tjera. Dy herë ishte përsëri Zeneli, ndërsa një herë ish-lojtari i Partizanit, Amri Rrahmani. Me këtë fitore Kosova kualifikohet për në fazën e eliminimit në Ligën e Kombeve, duke e kaluar e para grupin. Ndërsa pas kësaj fitore në dhomat e zhveshjes ka filluar një festë "e çmendur" e stafit teknik dhe lojtarëve, të cilët ia kanë marrë edhe këngës.

LIGA E KOMBEVE

LIGA D

GRUPI 3

Dje	Kosovë - Azerbajxhan	3-0
Maltë - Ishujt Faroe	1-1	
RENDITJA PËRFUNDIMTARE		
Skuadra	N	P
Kosova	6	14
Azerbajxhani	6	9
Ishujt Faroe	6	5
Malta	6	3

Ishullorët pretendojnë një penallti. Kuqezinjtë largojnë 'fantazmat', për momentin...



Jeton Selimi

Shqipëria gjen fitoren, Uellsit tërbohohet me arbitrin

Bekim Balaj shënoi golin e suksesit nga pika e penalltisë



Pas një shembjeje si ajo ndaj Skocisë, fitorja ndaj Uellsit ishte detyrim moral i lojtarëve ndaj fanellës dhe ndaj tifozërisë. Ndaj, kuqezinjtë nuk zhgënjëjnë në miqësoren e djeshme, duke triumfuar 1-0 përballë Bejlit me shokë dhe duke minimizuar në maksimum gabimet e shfaqura me skuadrën tjetër britanike të shtunën. Natyrisht që ky sukses nuk vlen pikë, por të paktën vlen për të zhbërë disi imazhin e shëmtuar të "Loro Borici".

Panuçi e nis ndeshjen me Etrit Berishën në portë, ndërsa në mbrojtje rikthehet Hysaj në të djathtë dhe me Ismajlin, që merr vendin e Gjimeshitit të dëmtuar. Tjetër rikthim në mesfushë, ai i Migjen Bashës, që krijon repartin me Xhakën dhe Linën, ndërsa në sulm krahët nuk ndryshojnë, me Uzunin e Grezden që mbështetin Bekim Balajn, i rikthyer titullar në këtë sfidë. Pjesa e parë nis më mirë për Uellsin (minuta e 23-të), por që gjithsesi nuk do të kërcënojë kuadratin e Berishës. Me kalimin e minutave rritet loja e Shqipërisë, por gjithsesi pjesa e parë mbyllet me rrjeta të paprekura. E dyta fillon shumë më mirë për kuqezinjtë, që nisin disa sulme radhazi në zonën e Uard, ndërsa sfida do të kulmojë në minutën e 58-të, kur Bekim Balaj do ta shndërrojë në gol penalltinë e fituar nga Taulant Xhaka. Shqipëria luan më mirë dhe i shkon pranë dyfishimit me Uzunin (minuta 63), ndërsa në minutën e 67-të, uellsianët pretendojnë një 11-metërsë për faull të Bashës, por gjyqtari maqedonas Dejan Jakimovski nuk e sheh kontaktin, ndërsa pak minuta më pas (77) protestojnë ashpër ishullorët të kryesori për një faull në zonë si pasojë e kthimit të topit të Berisha, që e kontrollon me duar, por kryesori edhe njëherë vijon lojën. Më pas, Shqipëria ka mundësi të mira ta mbyllë sfidën nëpërmjet

kundërsulmit, por nuk do t'ia arrijë, ndërsa rezultati nuk do të ndryshojë më deri në fund të takimit, me Sh-

qipërinë që gjen fitoren pas katër ndeshjesh, ku kishte koleksionuar 3 humbje e një barazim.

Gigs: E meritoni ta humbim këtë ndeshje

Trajneri i Uellsit, Rajan Gigs, nuk kërkon të fshihet pas gishtit në përfundim të takimit kundër Shqipërisë, ndërsa pranon me sportivitet se skuadra e tij e meritonte ta humbiste këtë sfidë. Gjithsesi, ai ka besim te të vetët dhe se shpreson që jenë gati për eliminimet që nisin në muajin mars. "Është ndeshja e fundit deri në mars, është e fundit këtë vit për ne dhe donim të fitonim. Ndaj Danimarkës luajtëm mirë, ndoshta merituar më shumë. Sot (dje) nuk luajtëm mirë dhe morëm atë që meritonim. Nuk shënuam ato raste që patëm dhe morëm humbjen që meritonim. Kam besim tek ekipi, lojtarë të mirë, vetëm se sot (dje) nuk kishin përqendrim. Por, është një grup i mirë. Ndonjëherë fiton më shumë kur humb një ndeshje", deklaroi trajneri i Uellsit, Rajan Gigs.

Por, prapaskenën e rrëfen presidenti

Duka: Panuçin e mbështeta përpara ndeshjes

Presidenti i FSHF-së, Armand Duka pas përfundimit të takimit Shqipëri-Uells tha për mediat se fitorja e kuqezinjve shërben për skuadrën në mënyrë që të rritet më shumë besimi. Ai shtoi se me Panuçin ka pasur edhe një takim para ndeshjes, por vetëm e ka mbështetur: "Rezultati ishte pozitiv. Pjesa e parë nuk ishte shumë e mirë, por pas asaj humbjeje ndaj Skocisë shërben për ndryshimin e atmosferës. Nuk kam diskutuar asgjë me Panuçin, përveç se jam munduar ta mbështes për të pasur paraqitje dhe rezultat pozitiv. Rezultati nuk ngre asgjë, por kthen besimin te skuadra. Fitorja na kthen besimin, nuk e bën skuadrën më të mirë, por jep më shumë besim. Duhet më shumë mbështetje dhe më pak mungesa e më shumë fat mund të bëjmë më mirë. Sot ata që ishin në fushë ishin më të mirë e mundshëm. Besoj se në ekip kombëtar duhet të jetë më i miri i momentit, pavarësisht nga moshja apo ekipit ku luan", u shpreh Duka.

TRAJNERI I SHQIPËRISË

Panuçi: Fitorja më ngroh, me Dukën jam takuar dhe e falënderoj

Fitorja ndaj Uellsit erdhi në momentin e duhur. Pavarësisht se vetëm një miqësore, Shqipëria dhuroi një tjetër lojë në krahasim me atë që bëri ndaj Skocisë. Por, pavarësisht kësaj, e rëndësishme ishte ajo që vetë trajneri deklaroi pas përfundimit të takimit. Ndonëse opinioni dhe media prej ditësh po pret shkarkimin e tij, Panuçi tregoi se ka pasur një takim të përzemërt me presidentin Duka, por nuk ka bërë publike atë se çfarë ata kanë biseduar.

Më në fund një fitore, pavarësisht se nuk kishte shumë rëndësi për rezultatet, por për shpirtin e skuadrës.

Më në fund, po, është

fjala e duhur. Skuadra gjeti shpirtin e duhur dhe arriti në një fitore. Më në fund skuadra arriti të fitonte, vuanjtëm, por në fund arritëm fitore. Edhe pse Uellsi kërkoi që të na barazonte, si çdo skuadër që hyjnë për fitore. Por, kjo nuk do të thotë që ndalojmë me kaq. Do përgatitemi, të vazhdojmë përpara për kualifikimin në europian.

Si ka qenë fryma e grupit gjatë këtyre ditëve të vështira?

Jemi ballafaquar, kemi folur, arritëm të gjejmë pikat ku gabuam dhe arritëm të vazhdojmë përpara në fitore.

Marsi, është i largët apo i afërt?

Për të arritur për të rikuperuar ndonjë lojtar, shpresoj që të jetë sa më larg.

A ishte përgjigje e lojtarëve, nëse e duan trajnerin?

Unë di që djemtë i kam pas krahëve, i kam me vete. Nëse do e dija që nuk do ishin me mua, do largohesha.

A fituar një lojtar si Ismajli?

Po, jam shumë i kënaqur, shumë serioz në fushë dhe profesionist. Besoj se do bëjë ndeshje të bukura në vazhdim.

Pse vetëm 2 zëvendësime në miqësore?

Sepse skuadra po luante mirë, nëse do kishim

shfrytëzuar më mirë disa raste, do shënonim më shumë gola.

Çfarë do të thotë për ju kjo fitore?

Edhe pse erdhëm pas një humbjeje, djemtë arritën të vuanin dhe të fitonin në një ndeshje të bukur. Edhe pse, morali ishte pak më i dobët.

Paralajmëruar se do të kishte një ndryshim taktik, jeni i bindur se kjo është zgjedhja e duhur?

Unë nuk dal në televizion, për të thënë që faji është i imi, por për të thënë që djemtë reaguam dhe arritën të fitonin. Kjo është dhe më e rëndësishmja.

Jeni takuar me Dukën?

Jemi takuar disa minuta para takimit. Më ka thënë diçka që është private mes nesh. Dhe i jam falënderues për çka më ka thënë. Ajo që është më e rëndësishme për mua është të dija që skuadra ishte gati. Skuadra sot ia doli.


Pas ndeshjes morët përgjegjësit duke thënë: Nuk kisha kurajë të bëja disa ndryshime. A i bëtë sot (dje) ato?

Po deri sa ndryshova, ndryshova taktikë. Duhet t'i japim kohë skuadrës që të reagojë.

Kë do të zgjidhje një ndeshje të mirë pa rezultat apo të kundërtën?

Do të zgjidhja të luanim keq dhe të fitonim, sepse në fund ka rëndësi rezultati.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- E famshmja Curie
- Më e mira është rekord.
- Inicialet e Kurosawa-s.
- Është edhe ai i mendimeve.
- Një mund të jetë zemërkau
- Është dollapi.
- Gjysmë mize.
- Fillojnë sefte.
- Ishte shkollë e Aristotelit.
- Ndodh në kufij.
- Bëhen me ambalazh.
- Janë idhnakë.
- Fillojnë titujt.
- Do të bëhen pemë.
- Ashtu si jeton heremitit.
- Është dhomë e lartë.
- Janë spanjollët dhe portugezët.
- Ishte filozofi që preu damarët.

- Janë gjuhë...veshi.
- Musketierët e Dumas.
- Lila këngëtare.
- Kufizojnë takimet.
- Ullmann aktore.
- Mbledh baskët separatistë.
- Fillojnë kapjen.
- Inicialet e Delon.
- Lumi i Bernës.
- Është numri të parit.
- Një thirrje me emra.

VERTIKAL

- Farrow aktore.
- Me Romeo në makinë.
- Rolet pa zë.
- Kufij itinerari.
- Ai ekzekutiv u bë bashki.
- Në mes të dhomës.
- Një tabu islamike
- Mbyllin fushatat.
- Janë festime
- Lehar kompozitor.
- Janë shtyllat për vela
- Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
- Duhen fituar me djerse.
- Piktura pa kura.
- Janë dokumente partie.
- Në fund të vitit.
- Farkëtoi armët e Akilit.
- Një është për kërcim.
- Athinaja e romakëve.
- Janë kapriçiot.
- Një tis mjegulle.
- Kërcimi i Fred Astaire.
- Edwards regjisor.
- Parker regjisor.
- Luan në kufij
- Inicialet e Rohmer.
- Fillojnë detyrën.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Lama i Tibeit.
- Janë vendet e lira
- Martin i Jack London.
- Comaneci e famshme e gjimnastikës.
- Ekstrema në sirtar.
- Janë princër arabë.
- Një treshe në skenë.
- Një provë inteligjence.
- Gjysmë tatimi.
- Gjysmë eolike.
- Ekstrema në studim.
- Bëjnë stil të lirë
- Ndal në kufij
- Kaluar në krye.
- Një tragjedi... e Dreiser.
- Grier aktore.
- Dashi kur mungon ai
- Është zanore në filma
- Kufizohet në kufij
- Ente Civile Europiane.

VERTIKAL


- Është halli.
- Fillon me rruga...
- Kastile janë në fund
- Janë në skajë
- Është vendi aderues
- Ka kryeqytet Doha.
- Inicialet e Daudet.
- Ndërmarrje Industriale Tiranë.
- Igji te Lazio.
- Janë zjarrvënës.
- Flanders e Defoe.
- Shkroi Rinoceronti.
- Ekstrema në slam.
- Janë trille.
- Qytet italian.
- Jepen për hartim.
- Fillojë takimet.
- Kufizojnë kënde.
- Janë vendet e para.
- Një greminë
- Është logarinq që qërohet.
- Ndiquen me ilaçe.
- Masari aktore italiane.
- Është melodramë.
- Një thirrje e dëshiruar nga maja e direktur.
- Kush ka... fërgëllon.
- Një i fundit mbi të gjithë.
- Një pjesë e satelitëve.
- Në krye të njerëzve.
- Sikur janë në krye.
- Inicialet e Taylor që qe aktore.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

6		4	9						
					8			5	7
	8	9	1	3	2				6
	3		2	1		9	4		
9				5	3				
	1			3		5		2	
			3		8				5
1	4		5	7		3	9		
2				4	8				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	7	2	5	9	3	6	1	4	
3	5	4	6	8	1	7	9	2	
1	6	9	2	7	4	3	5	8	
7	4	5	9	2	6	1	8	3	
9	8	3	7	1	5	2	4	6	
6	2	1	3	4	8	9	7	5	
2	3	8	1	5	7	4	6	9	
4	9	7	8	6	2	5	3	1	
5	1	6	4	3	9	8	2	7	

Argëtim filozofik

-Kush nuk ka plagë në dorë mund të prekë helmim me atë dorë: helmi nuk penetron aty ku nuk ka plagë; dhe nuk është mëkat (vepra) për ata që nuk e ka mëkat.
-Mos i besoni shkrimeve të vjetra, mos besoni asgjë vetëm se populli juaj i beson, ose sepse ju kanë detyruar t'i besoni që nga fëmijëria. Ndaj çdo gjëje veproni me arsye; pasi ta keni analizuar, nëse mendoni se është mirë për të gjithë, atëherë besojeni, jetojeni, dhe ndihmoni fqinjën tuaj ta përjetojë edhe ai vetë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	6	8	3	6	10	10	4	16	3	2	T	E	K	B	O	M	B	R	E	D	H	
10	3	9	5	7	4	8	8	6	12	4	O	R	A	T	O	R	E	T	E	S	E	
4	4	19	4	11	1	2	3	18	5	2	G	N	O	T	A	R	E	T	T	M	T	
18	11	5	6	5	13	5	9	4	7	3	E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
5	12	2	2	5	6	3	2	9	5	5	R	S	L	R	E	T	E	E	R	I	K	
											P	E	L	O	T	A	D	V	M	A		
5	2	3		3	7		2	5		4	6	1	S	O	T	R	T	A	R	E	E	T
13	3	12	3	2	3	4	2	5	13	5	T	R	G	P	A	R	E	T	E			
2	13	16		2	2	5	5	12	2	5	E	T	L	A	R	I	T	M	I	A		
17	12	4	1	12		7	6		2	13	F	I	L	I	Z	A	T	E	A	G	A	
5	4		7	4	8	4	1	12	5	6	4	2	A	D	I	T	E	T	T	O	M	
9	13	8		2	17	6	8	2	3	2	N	O	B	I	L	E	B	A	N	A	L	E

- Është më e rëndësishme të parandalosh që një kafshë të...
- Vdekja nuk duhet të kihet frikë nga të...
- Veçim virtyti garanton një Karma të mirë dhe...
- Në të vërtetë kurrë, këtu poshtë (Bota materiale), nuk mund të shuhet urrejtjet me urrejtjet.

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

A	V	A	T	I	S	A	L	A	M	I	N	A
L	A	N	A	F	E	A	R	I	S			
A	L	N	E	N	E	N	A	P	T	O	P	B
N	E	G	E	R	S	I	R	A	T	B	I	
S	A	M	A	S	M	O	D	E	U	M	I	R
I	S	A	M	T	A	R	A	F	F	A	R	A
M	R	O	N	I	N	A	R	I	E	T		
H	A	B	E	R	I	O	M	A	R	A		
R	E	I	T	S	E	R	I	T	E	T		
T	E	M	E	B	E	L	I	V				
O	T	M	E	R	I	T	A	S	A	M		
M	A	R	I	A	N	A	A	R	M	A	N	I
M	A	R	N	I	E	P	R	M	I	T	E	
I	N	A	T	U	M	A	D	T	E	S		
S	T	U	S	E	N	D	E	R	E	A		
T	E	L	T	U	N	D	I	M	I	A	U	
E	N	K	E	N	D	I	M	I	S	L	A	
R	A	A	F	J	O	E	B	E	L	A		
I	T	A	A	A	N	N	A	R	I	T		
O	K	A	N	A	I	S	A	R	N	A		
Z	E	L	L	I	L	L	M	E	D			
E	T	O	K	A	R	I	L	T	O	R		
T	O	K	A	R	L	N	L	E	R	A		
M	I	N	I	M	A	L	E	S	T	E	R	

